

E mban mend kur të shkrova se ai sapo më kishte lënë?  
Mbase të kam thënë "e lashë",se ato kohë inati qe më i fortë se dhembja,po c'rëndësi ka?Lamë njëri-tjetrin,për të qenë brenda.  
Erdhën ditë e net vetëm.Jo se netët i kishim kaluar bashkë,por ditët pa të nuk shtyheshin dot para.Sidomos nuk përballohej zgjimi fiks më 5:00,kur si nëpër ëndërr pyesja veten:"K gabova?"-"Gabimi qe qysh në nisje",-vetëpërgjigjesha,pastaj,në gjumë e sipër,kujtoja c'më kishte thënë në krye të lidhjes:"Kur të ndahemi,nëse ndahemi,kujto grindjet tona(që s'ishin edhe aq pak),mendo vetëm keq për mua,do të jetë më e lehtë për ty".  
Pastaj flija,pastaj zgjohesha,shkoja në punë,vija nga puna,flija përsëri,zgjohesha më 5:00,flija më 6:00,cohesha më 7:00,shkoja në punë më 8:00 dhe cdo ditë,cdo minutë e harroja nga pak dhe e doja më shumë.  
Por atë doja e një tjetër kërkoja,një tjetër si ai,një të panjohur për ta njohur të gjithin për vete,ti nuk je e vetmja që di se ai ishte i martuar kur ne u lidhëm,por je e vetmja që e di se nuk ka një të ngjashme me mua në orvatjet e dështuara dëshpëruese të kërkimit në fjalë.  
Por kesaj here kisha vendosur te kerkoja me gjithë dijet e perftuara nga humbjet ne vite (te cilat,te siguroj,vetem humbje te reja pjellin) dhe nga leksionet e vjedhura neper dialoge me ato qe une,ti dhe bota i quajme kurva.Keshtu qe kerkova sa kohe mes te njohurish,kujtimesh,copash ditari te fshehura e te degjoja ish-ish te dashurin qe fliste ne radio,ndersa une lexoja nje vellim poetik te porsadale te ish-ish-se dashures se ish-te dashurit tim.I nderpreva me urdher radion,librin ddhe lotet.  
Mengjesi me kapi me nje ndjesi se me priste dicka e re,dicka ndryshe ,e paardhur kurre deri me pare.  
E kam me te thene se dashurine e jetes njeriu e takon befas,kthen koken dhe shikon ate,ate qe ka dashur e pritur gjithemone.Sa me shume ia perseritja vetes,aq me ngultazi i shikoja njerezit neer rruge.I fiksoja ne menyren me te pacipe te mundshme,duke pritur nje shkendiye magnetike me nje ankth edhe me te madh sesa ai qe provon kur pret te plotesohet viza e dyte e testit te shtatezenise.  
Por hic,asgje,asgjekundi.Te gjithë ishin te martuar.I urreja grate e tyre edhe pa i njohur.  
Kur pashe se nuk kishte asgje me te mire per te bere sesa te prisja e lashe kerkimin.  
Nisja t'i denoja ditet ne pune.E ke vene re edhe ti:sapo ta dusha punen tende,nuk ehste asnjhere motiv i mjaftueshem,kur je vetem.Nje mikeshe e ime thote se te gjithë ikin nje dite,vetem pune nuk te le,ndaj ps saj ia vlen te kapesht fort,S'e di!E kam vrare mendjen per kete shpesh,sa here ezihesha me ate para lajmeve dhe futesha ne banjen e punes per e qare apo vjelle.Ose,kur ne zhegun e fushatave elektorale ,nese ai priste du bileta per te ushetuar,mua me dukej se zgjedhjet kishin mbaruar dhe nisesha.Ndoshta,ndaj femrat ,edhe me te aftat e races,jane nje hap pas meshkujve,ne rastin me te mire.I tradhton zemra pikerisht atehere kur nuk duhet.  
Ne njerënjë prej diteve qe i rendoja me keso persiatjesh,duke pritur

gjumin ,me trembi zhurma qe ben celulari kur sjell nje mesazh te ri.  
Keshtu nisi historia ime e sms-ve me nje te panjohur nje te diel  
shtatori.po t'i tregoj gjithme c'shkrova e me shkroi,pa ndalur te te  
shpjegoj. Eja pas meje!

20.092002

Ora 17:40

I panjohuri-Nuk te pashe ne lajmet e drekes.nuk je ne Tiran?

Unë-Kush je ti?

-Nje i njohuri yt i vjeter.

-Nuk kam te njohur ,aq më pak te vjeter qe nuk dine te perdorin shkronjen  
ë.

-Ti ne te vertete i perdor mire ë-nëmpe nuk di te perdoresh asgje tjeter...

-Mos keni ngaterruar nr?Ju lutem ,mos me shqetesoni!Nuk ju njoh dhe nuk kam  
deshire t'ju njoh.

-E di kush je ,të njoh mirë,dua të më njohësh edhe ti.

U permiresova me ë-në me duket...

Po ti c'do permiresosh prej meje?...

-Kush je?

-Nje njeri qe e ke fyer dikur,pa te drejte.

-do te marresh hak tani?Pse te kam fyer,personalish apo nga ekrani?

-Oh,sa te pelqyeka vetja!Fyerja nga ekrani,nuk je kaq e sofistikuar  
ti.Jo,jo ngjarje banale,por me la shije te keqe,m'u duke vulgare,e  
rendomte,sic edhe je ne te vertete.

-Kush dreqin je,idiot?!

-Ja,kisha te drejte ,apo jo?E nxore veten.Kaq per sot,Shkruhemi nje dite  
tjeter.

21.09.2002

I panjohuri-He,c'po ben sot?Apo po shijon nje nga ditet e tua koti?

Une-Ku e di ti se ditet e mia jane koti?

-Dukesh.kur jep lajmet,e ke te shkruar ne buze sa kot jeton.

-Idiot!

-Nuk di te shash ndryshe ti?Ma the nje here dje se isha idiot.Jepi,tjeter!

-Kush je ti?

-Idiot,pra.Ndersa ti,me vjen keq te ta them,por me duket,ose me kane  
thene,se je budallaqe.

-U binda se nuk me njeh,sikunder thua.U binda se nuk dohet te komunikoj me  
te panjohur.

-Te njoh.Me fal per fyerjen.

-Lexo,o njeri,se nuk dua ta du me cili je?Une vetem budallaqe nuk jam,per  
fatin ti te keq.

-Si do ta ndreqesh gafen qe bera?Do qe te vij dhe te te kerkoj ndjese balle  
per balle?

-OK.Hipi bicikletes dhe eja ne punen time.E di nga bie,besoj?

-Po sikur te them se kam makine dhe ti ke hipur ne te?

-Kur keshtu?!

-Ah,mos kerko shume!

-Po c'rendesi ka ,a the se do te vije te me takoje tani?

-Thashe,por nderrova mendje.Nuk eshte casti i duhur.Pastaj,ti u zbute.Harroke kollaj.

-Mire,kurre mos ardhsh!Ti duhet te jesh plak,i urryer,i shemtuar,perderisa ngurron te me takosh.nuk eshte fyerje,eshte konstatim.

-Oh,sa larg se vertetes!As plak,as i urryer,as i shemtuar.Por pavaresisht,nuk do te vij sot te te takoj.

-Si te duash!Quajete mbyllur komunikimin me mua.Tani do ta fshij sms-ne tend te fundit dhe nuk do ta kem me numrin tend.Me sa kuptoj,te je ndonje maniak ekрани.gjen numra celulari dhe shkemben mesazhe.

Kerko ndonje numer tjeter me mire,se nuk me pelqen te mendoj se jam e cmendur.

23.09.2002

I panjohuri-Dje nderpreva komunikimin qe te mos ndiheshe e cmendur,sic the.ne darke me ke marre ne tel.E fshive numrin,por kete numer vetem ne te dy e dime,e s'kish kish tjeter vec teje te me telefononte.

Eshte numri im i dyte vetem per ty.Pres,por jo zile me hile...

Une-A mund te ndajme bashke dicka te rendesishme per mua?Sot kam ditelindjen,ndaj te lutem pa fyerje.

-Sinqerisht,URIME!Ndoshta heren tjeter do te jemi bashke,qofte edhe si miq.

-Mund te jemi edhe sot,ndoshta jo si miq,por si te panjohur.Eja me tako ne pune!

-Ou,kukulla e ekranit nuk paska me ke te kaloje ditelindjen!E po eshte shpejt nje vit me shume,qe iku.

-Te thashe te vish sot ose kurre me!

-Tonin urdherues ta urrej.

24.09.2002

I panjohuri-Nuk m'u duke dite e mire e djeshmja per ty.

Te pshe ne lajme.Mund edhe t'i lije ditin tende te lindje,apo vertet nuk kish asgje me te mire per te bere?

Je zene me te dashurin?

Unë-C'te duhet ty?!

-Po me provokon keshtu?Cfare do te zbulosh?Mos u mundo shume ,ta tregoj vete.Une nuk kam te dashur.

-Kjo eshte fraze standarde intervistash neper revista.

Une te kerkova sinqeritet ne komunikim.

-E para,ti nuk ke te drejte te me kerkosh gje;e dyta,ti nuk me ke kerkuar asgje,aq me pak sinqeritet.

-E po po ta kerkoj tani.dua te flasim sinqerisht,si me veten.

-Ne rregul.Kush je ti?Sinqerisht.

-Une jam nje njeri qe do te te njohë.Mund te te njihja edhe duke t'u afruar,por mendova se keshtu edhe me intersante,me e cuditshme,me e

vertete.Dua te flasim gjate bashke.

-Pse nuk zgjodhe rrugen me te shkruter,duke m'u afruar ne nje feste,kafef,apo nepermjet te njohurish te perbashket?Pse beson se une mund te vazhdoj te komunikoj me ty me mesazhe?

-Sepse je kureshtare.Dhe ben mire qe je,kureshtja do te te ndihe ne fillim,pastaj do te te vije deshira per e folur,madje deshire per t'u takuar.

-Oh,sa parashikues!Edhe nje pyetje,meqenese po flirton me mua ne mesazhe:je i martuar?Jo per ndonje plan te ardhmeje,por se nuk dua te kem asnje marredhenie,qofte flirt telefonik,me burra te martuar.

-E njoh marredhenien tende me nje burre te martuar.E dine te gjithë,por une nuk te paragjykoj.Unë nuk jam i martuar.

-Cfare dine te gjithë?Kush je ti?

-E lame te jemi te sinqerte.nuk dua te besh sikur nuk kupton,as te fshehesh gjera te cilat i di mire.Sepse pastaj nuk do te te besoj per ato qe nuk i di.

-Jo,vertete nuk kuptoj.Cili eshte ky burre i martuar per te cilin flet?

-E kuptoj,jovetem qe shtires,por edhe gjenjen kur thua se je vetem.Ti nuk je vetem,ndaj po e mbron ate nga kureshtja ime.Te vafte mbare me dashnorin tend,sic te ka vajtur deri me sot!

-Sa mbare me ka vajtur me ka vajtur,ti duhet ta dish po aq mire sa une,perderisa me ndjek dhe informohesh per mua.

Me vjen keq qe komunikovadhe i kushtova kohen dhe vemendjen time nje detektiv.Tani kuptova cili je,cfare kerkoje dhe sa budallaqe u tregova.

-Nuk jam detektiv.Te mos keqkuptohemi kot.Por jam i inatosur qe me genjen.thua se je vetem.Unë e dija kete,ndaj nisa te te shkruaj.Por te pashe sot me te,ne nje kafe,ne publik,ne mes te dites.nuk duhet te jesh detektiv per te te pare ty ne kafen ku shkoj shpesh.

-Tek Akademia?U pershendetem?Te njoh une ty?

-Jo,nuk u pershendetem.Ishe shuem e sene me te.E do akoma?

-Po,po ti je detektiv,ose je vete ai,qe me shkruan per te mesuar ne ndiej akoma per ty.Po me pyet,o njeri.Me pyet ne sy dhe do te ta them.

-Po luan keq.Nuk je hic bindese.E leme me kaq sonte.Po ta perseris.Do te vazhdojme te shkruhemi bashke neser,pasneser dhe shuem dite te tjera,me dy kushte:nese je e lire dhe nese je e sinqerte.Ciao!

30.09.2002

I panjohuri-Te lshë vetem disa dite per t'u menduar.

He,si thua,je e lire dhe do te jesh e sinqerte?

Unë-E lire jam.E sinqerte,nuk di si ma kerkon kur vete nuk je i tille.Ti je real,por jo per mua.Njoh vetem nje nr. celulari tendin,qe e hap dhe e mbyll kur do.Me tako,po ta kerkoj sersih,Ky eshte kushti imper te vazhduar.

-Jo,ti nuk mundesh te vesh kushte.Unë e hapa kete loje,qe do te vazhdoje me kushtet e mia.

-Pra,eshte loje?

-jo nuk eshte loje.Nuk kam kohe te luaj.Por dua te te njoh dhe te me

njohesh,ndryshe nga c'do mundeshim po te ishim perballe.I ke marre parasysht ato takimet standarde:'Si je?C'thote puna?Une te dua,po ti?"nuk ka per te funksionuar nese takohemi.

-Pse,ti me do mua?

-Besoj se sms-te jane domethenese.

-mos me fut friken.Sot isha tek Akademia dhe te kerkoja gjithandej.Dhe nuk dija ke kerkoja.

-mos ji kaq e pasigurt.Beso tek une.Kridhu ne loje,e gjitha.

-Ndaj ndiej inat me veten.Se di nuk pse te besoj.Me vjen turp qe nuk detyroj dot veten ta nderpres komunikimin.

-Dhe nuk ke pse ta besh.une dua te flasim per te gjithë jeten.Por tani per tani ende larg,pasi jane te tjere shume afer...

-Cfare thua?Per ke te tjere flet?

Heshtje...

-Pergjigju,pra!Ku do shkojme me sms?

Heshtje...

-Nuk mendon se nuk do te shkojme asgjekundi.ti me frikeson me mendjemadhesine tende.Dhe me ndjell.

Kjo u kuptua tani.Pse nuk takohemi?

Heshtje...

-Pergjigju,dreqi te haje!Me tako.Pergjigju,nuk mund te ikesh si frikacak!

Heshtje...

-Bej si te duash:ose rri.ose ik.S'dua te bej qaramanen dhe budallaqen!

Heshtje...

-E di cfare?Tani po bindem se po tallesh,vetem je tallur qe nga fillimi.Kenaqu,te eci!Shijoje!

-Qetesohu!Nuk jam tallur asnje cast,as do te doja te talleshe si ti.Rri me veten tani ktheju edhe nje here sms-ve qe me ke shkruar.Do ta kuptosh sa nervoze ishe.

Nuk kemi ku shkojme ,nese ti vazhdon me nervozizem.-Ah,ia arrite te me tundosh dhe tani me thua terri me veten!

-Merre shtruar.mos u nxeh.Naten!

-Kuptoj!Tani do te mbylesh celin,duke me uruar naten,kur ora eshte vetem 20:00 dhe do ta mbyllesh mbremjen duke pire kafe me mikeshen tende.Ju paraftyroj duke qeshur me budallaqen qe shkruan sms!

-Permende mikeshen time?Aludon se e njeh.Do te ishte cudi ,kur ankuhesh se nuk me njeh as mua.

-Nuk te njoh,por dua.Ate nuk e njoh dhe as dua.

-Pse ma permende,nuk kapa nentekstin?

-Sa u shqetesove!Qneka e rendesishme per ty!Po nga une c'kerkon,atehere?

-Se pari,partneri nuk ngacmohet;se dyti,nuk te kerkoj per castin-kete e kam zgjidhur.Te gjithë e kane te lehte kete.Mbetet perspektiva;tjeter gje kjo.

-Se mos keqkuptohemi si ngahere.Nuk jam xheloze,s'ka si tejem per ty.Dhe gezohem qe e ke zgjedhur castin,por shume caste bashke bejne perspektiven dhe jo sms nervoze.Kupton?

-Kuptoj.Kuptoj qe edhe ti e ke zgjedhur castin,ndoshta edhe perspektiven.Ketu ndryshojme ne te dy:ti shume kureshtare ,une pretendonjes.

-Ti nuk mund te dish asgje per castin dhe perspektiven time.Me fal,por flet kot.Dhe as une nuk mund te te tregoj,se nuk te njoh.Ndaj s'mund te t'i besoj sekretet e mia:ne dua kend,ne bej dashuri,si qaj,si vuaj,si lodhem,si vetsugjestionohem,ne jam vetem a vet e trete.Si te t'i them ty.o pretendues,a s'di cfare emri te te ve?!

-Mendo si te duash per mua dhe qellimet e mia.Here te dukem talles,here i frikshem,here mendjemadh,here detektiv.Per ty flas edhe kot,madje edhe provokoj,ngaqe s'di asgje.Meqe ti do,une po zhdukem nga celulari yt.Mbetem dashamires.-Si te ta them fare shqip o dashamires?une nuk dua qe ti te zhdukesh,dua qe ti te shfaqesh.Por ti je si une,qe, kur kam frike te kaloj bulevardin nga trafiku,marr taksi.

-Pse mendon se te te takoj perben rrezik per mua?Nuk ka kuptim ta bej kete pa pasur nje shprese.Asgje me shume ,fare thjeshte.

-Te kujtohet qysh shkruhem?Qe me 15:30.nuk me ka ndodhur me apre.Me beso mua tani,te te besoj une me vone.Me tako.

-Problemi eshte se tani nuk mund te te besoj dot.Kam arsye te jem i sigurt se nuk je e gatshme per lidhjen tone.

-Arsye?Po kjo qe po bejme,a ka arsye?Ti nuk je bindur ende te me takosh?Cfare pret?Sa per te te dhene nje dore;une dhe celulari im jemi shume te afert qysh se ke ardhur ti.Njerezve afer meje u vjen keq kur me shohin duke shkruar e pritur sms,por une ndihem mire.S'e mohoj.Po ti si ndihesh?

-Shume mire dhe shume keq.E mbyllim per sot,se lame nam.

-Dakord.E kalofsh mire naten!

-Edhe ti.

1.10.2002

I panjohuri-Pershendetje!Te ka marre malli?

Heshtje...

U-Ah me fal!Qenke me ate?Me fal!

Une-Jo,nuk jam e zene me ate,jam me nje mikeshe ne kafe.

-Po pse nuk pergjigjesh,atehere?Je e zemeruar me mua?

-Jo e zemeruar,e merzitur.-Nuk eshte vone per te pire kafen ne kere ore,apo do te rrish per dreke aty ku je me mikeshen tende?

-Po,besoj.

-Pse kaq thate?

-nuk siha e perqendruar.Po vezhgoja nje cift.Djali ha paidhqe,vajza peshk.Nuk dihet sa kohe d ot'u duhet atyre per te gjetur nje gjuhe te perbashket ushqimi.

-Do te thuash se ne s'po e gjejme dot gjuhem tone te komunikimit?

-Po te vonohemi akoma me sms dyshimtare,veshtire do te jete;aq me keq kur dhe keto sms vijne kur ti do.U bese dy dite qe nuk shkruan.

-Te thashe se jam ne Jug me mikeshen time?

-Jo,nuk me the.

-Sot,besoj do te jem ne Tirane.tani ajm ulur per te drekuar.  
-Cfare i thua asaj per sms qe dergom?  
-Nuk i them asgje.Pse duhet t'i them?  
-E po mua nuk me duket e ndershme te me shkruash kur je perballe mikeshes sate.  
-E drejte.Ky arsyetim qendron edhe per ty.nuk dua te me shkruash kur je ne kafe me te.  
-Nuk te kam shkruar ndonjehere.  
-Po e ben tani.A nuk je duke shkruar?  
-Une nuk jam me te tani.Jam me nje shoqe ,te thashe me duket.Pse ben sikur nuk kupton?Apo do te justifikohesh?  
-Mos u nxeh!Une nuk kam c'justifikoj,Te kam thene se kam nje mikeshes.Vazhdo dreken tende,une timen.  
Shkruhem i nesi.

1.10.2002

ORA 20:30

I panjohuri-Te thashe "shkruhem i nesi",por nuk m'u durua.Vazhdon te jesh e merzitur me mua?

Une-jo,s'besoj.Duhet te jem?

-Vertet?E ben shpesh kete ,ri me dike dhe mendon per nje tjeter?

-Nuk ecen sonte.nuk dua te me ngjisesh merzine tende.Naten!

2.10.2002

I panjohuri-nuk te shkrova gjate dites,isha i zene me pune.Me fal.

Une-C'pune ben ti?

-nje pune te ngjashme me tenden.

-Une merrem me lajme.Cfare ka te ngjajshme me lajmet?

-Biznesi,puna ime.

-Dhe aq nuk me duken te ngjashme.Merresh me biznes,vertet?Nuk e dija qe paska biznesmene kaq te ngeshem sa te merren me sms!

-Une nuk jam i ngeshem,jam i interesuar.

-Dhe nuk e dija qe ka biznismene te mencur,ne kuptimin teorik te fjales.Me duken praktike ata qe njoh.

-Pa fyerje.Tashme e di qe s'me pelqen.Ku je tani?

-Ne shtepi.

-C'po ben?

-Po lexoj.

-Une po futem ne nje takim,afet shtepise sate.Mbaroj per nje ore.Shkruhem i nesi.

-Ti e di ku e kam shtepine une?

Heshtje...

-Ok.Uni po vazhdoj te lexoj.Me shkruaj kur te mbarosh.Sa e cuditshme!Me duket sikur ti do te vish ne shtepi me te mbyllur takimin.

-Do te ndodhe,shume shpejt.

3.10.2002

Unë-Të prita mbrëmë,nuk me shkrove.Celin e kishe vetëm mbyllur.

-I panjohuri-Më fal qe te bëra te presësh.Shkuam ne Durrës pas takimit.Dhe si tavoline vendosem t'i mbyllnim celularet.Pime deri ne mëngjes.Tani kam ardhur dhe me dhemb koka shumë,por duhet te bëj një dush e te dal.

-Mund dhe te ma thoshe.

-Pse kështu?

-Sepse kështu e lame.

-Po të rregullosh nuancat e shkrimit,mund te te jap te drejtë.

-Dhe pa i rregulluar e drejta edhe me mua.

-Yes.Duhet te te lajmeroja,por nuk doja te nxeheshe dhe e lashe fare.Do te gdhinte dhe do të flisnim,siç po bëjmë.

-Po shkruhem ,nuk po flasim.Shkruhem nga darka.Ti akoma nuk ke shkuar ne pune?

Jo,jam gjithë pertese sot.Po të dal pak nga pak.

-Me shkruaj gajte dites.Me pelqen te di ku je e cfare ben.

-Me shkruaj edhe ti.Edhe mua me pëlqen.

3.10.2002

I panjohuri-Unë jam gati për te shkruar.Ti je e lirë?

Unë-Po,jam ne pune,por s'kam pune.

-Vetëm te lutem,të mos falsim për takimin e ardhshëm sot,gjejmë një teme intersante.Dhe nuk kemi pak.

-Po mua nuk me duket asgjë me intersante sesa te te takoj.

-Pa ditur qe je ndare,nuk e hedh dot hapin.

-Unë jam ndare tre muaj me pare.

-Po duheni akoma.

-Unë jo.Ai nuk e di,duhet ta pyes.

Heshtje...

-Nuk e bseon?

-Jo,a e beson ti këtë qe po thua,ky është problemi.

-unë jam rremuje,kam rremuje ne atë qe dua,besoj dhe them.jo për shkakun tënd jeta ime sentimentale ka ndryshuar,por për shkakun tënd ka ndryshuar impenjimi im.

-Ndaj atij?

-Ndaj punës.Po ndryshon perqendrimi im ne gjithçka.Kjo nuk me ndodh një herë ne muaj,a një herë ne vit.Mos me keqkupto,nuk po të them se kam gjërat rremuje dhe te kerkoj ty te vesh rregull ne jetën time.

Por nuk ehste sekret te te them se,megjithëse absurd,komunikimi ynë me tërheq dhe dua ta prek.Nuk me pëlqen te luaj pa ditur fundin.

-Loja ime te demton ty vetëm për castin,ndërsa loja jote mua me fut ne qorrrokak për gjithë jetën.Ka goxha diference,apo jo?

-Unë e njoh veten.Mos u vono,sepse ndiej qe do ta marr sërish ne dorë vetekontrollin.Me tako.Unë dua fort te te takoj.

-Me ndeze.Mos po i bie shumë gjatë dhe duhet te takohemi?Unë them se jo,pasi për castin te dy kemi te tjerë.Unë kam nevojë për një lidhje te



thelle.

-Ndërsa unë kam nevojë të të materializoj.dua të shoh kujt i shkruaj,kujt i lutem aq shumë ta takoj.Kush ma sjel humorin kur dergon sms dhe ma prish kur e mbyll celularin.

-Nuk me duket moment i dukur t'i bashkoj ne një të vetëm mua realin dhe mua shkruasin e sms-ve.Mos nxito as ti.Ky çast do të vijë natyrshem.

-Si natyrshem?Ç'do të ndodhë derisa ai të vijë?Ti do të me pyesesh,unë do të perjigjem.kështu mendon të vazhdoje?Kështu beson të me njohësh?Por unë kam frikë të të rrefehem.Pse duhet ta bëj kere me një të panjohur?

-Frike?Nga komunikimi me sms?Unë nuk kerkoj asnjë rrefim nga ti,asgjë nga e kaluara,asgjë nga e sotmja.kerkoj të provoj të ndërtojmë të ardhmën e perbashke,nëse do të mundemi ta bëjmë.S'do të me interesonte asgjë jashtë këtij konteksti.Ti je kryesorja ne këtë proces njohjeje deri ne vendimmarrje.Nuk e ndien?Apo s'e vlerëson?

-Sa vjeç je?

-40.

-Kaq vërtetë?

-Kureshtja e famshme!Kaloje këtë cak.Po flasim për shumë me tepër.S'e beson?

-Me dukesh shumë i mirë er te qenë i vërtetë.Me ndje për mosbesimin.Unë i urrej njerëzitë që nuk kuptojnë dhe sidomos urrej ata që luten,por ja që u bëra njere prej tyre.Zere se nuk te kuptova fare c'me the deritani,por te lutem unë,personi lutes,kam nevojë të të njoh që të mund të jem "unë".Perndryshe nuk mund të vazhdoj të komunikoj.

Mirë,ma shpjego pse e ke të pamundur të komunikosh pa me njohur,kur deri tani e ke bërë dhe s'ke qenë e vështirë.

-Seps unë mendoj se dy njerëz ndajne kohën bashke që ta nxitin dhe frymezojne njëri-tjetrin.Nëse nuk e normalizojme dhe materializojme marrëdhënien tonë,unë pak nga pak do të ve syze,do t'i kem gishtat me kallo dhe do të bëj antireklamen e AMC-se:"E marrë prej sms-ve".

-Je shumë e mirë,ndaj i hyra këtij komunikimi të çuditshëm.Por e kqejja është se je e mirë edhe për...E jo vetëm për mua,ndoshta ka edhe të tjerë që tundohen po kaq nga ti.

-Çfarë fsheh ti?Je i burgosur?Je gura?Çfarë të pengon realisht të me takosh?

-I burgosur-nga ndjenja për ty.Grua nuk jam,kerkoj.Uroj të mos kem gabuar me ty.

-Çfarë do nga unë?

-Të mos perseritim gjërat e thena një herë dhe të kemi parasysh gjithçka kemi thënë,qe të rrisim rendimentin e komunikimit.

-Ah,kur unë yes,biem ne përsëritje?Po ti nuk veteperseritesh kur më flet vetëm për atë?

-Dhe ti asnjhere nuk me thua asgjë,edhe pse tani e ke të qartë se ai është pengesa kryesore e takimit tonë.nuk kam dashur të futem mes jush,ndaj nisa komunikimin me sms.

-Tani clodhu.Nëser do të flasim prapë.

4.10.2002

I panjohuri-Sot e ke pasur celin te mbyllur gjithë ditën.

Ke qenë e zënë?

Unë-Jam ne Berlin.Kam ndërruar dy avione,ndaj ka qenë mbyllur.

-Nuk me the gjë mbrëmë.Mirë po kalon?Je me mikun tënd?

-jo,jam për pune.Mirë po kaloj.Kur je jashtë,edhe era e trupit tënd te duket si e një tjetri.

-Të ndiej te çuditshme sot.Po të pëlqen Berlioni?E ke për herë të parë?

-Po.

-E lemë me mirë komunikimin për sot.Shijoje Berlinin.Mua këtu me ke kur te kthehesh.Kur kthehesh?

-Ne fund te javës?

-Ndoshta shkembehemi ne aeroport.Unë nisem për një udhëtim te gjatë në fund te javës.

-Si do të shihemi,ku,ne Berlin apo ne Rinas?

-Nuk e di.Mbase dhe nuk shihemi.Unë do të qëndroj gjatë jashtë.Mund të ndodhë gjatë gjithë pjesë tjetër te tetorit.

-D.m.th,nuk do të shkruhemi,këtë d ote me thuash përderisa po me keshillon të mos shkruaj kur jam jashtë,as ti nuk do ta besh?

-Them se jo.Por do të me marrë malli.

-nuk besoj se do me gjesh kur të jesh sërish ne Tiranë.

-Pse,ku do të shkosh?

-Asgjekundi,por nuk do të jem për ty.nuk me tërheq me ky vrap me pengesa.Ndalo,dysho,terhiqu,shtyje...s'di ku na çon!

-S ite dusha,nëse do,je ne kohe për t'u terhequr.

-Oh,kaq lehtë qenka për ty?!Mirë atëherë,zere se është po kaq lehtë edhe për mua.Terhiqem.

-U binda qe nuk je personi i duhur për mua.Me mirë qe ndodhi kështu.

-Po,te jap te drejtë.Nuk te meritoj.Je i vetekenaqur,unë e pakenaqur,Je racional,unë emocionale.Je i zënë ne cark nga castet.Unë se njoh këtë fushe.

-Të uroj fat dhe të duhet tani qe po kthehesh përsëri te ish-miku yt,nëse je ndare ndonjëherë.

-Ja,ndaj dua te iki,ti me dukesh krejt indiferent ndaj meje dhe me shumë i interesuar për ish-lidhjen time.Por te uroj dhe un fat.dukesh qe ke,përderisa nuk me njohe.Jam njeri qe,thënë ndryshe,te çaj koken.Heshtje...

-Nuk me duket se po iken me qejf,përderisa nuk e ke mbyllur ende celularin.Se mos unë!Por s'kam c'bëj,duhet.

KOMUNIKIMI MBYLLET DERI ME 3 DHJETOR

4.12.2002

I panjohuri-Miremengjes!Kam pershtypjen se je penduar qe e mbyllem komunikimin.Unë po.

Une-Edhe une po.

-Kesaj here do te doja ta rinisim,por pa u shperqendruar nga tema jtoe e preferuar,takimi,Une e nisa,une e rinisa,me ler mua te udheheq.

-Dorezohem.

-Kam qendruar jashte per shume kohe.U ktheva para disa ditesh,te pashe ne ekran dhe ne rruge,me kishte marre malli.

-Edhe mua.

-Po ti nuk me njeh.

-Malli per ate qe nuk e njeh eshte me i keq,perndryshe so do te te ktheja pergjigje menjehere sapo dergove sms-ne a pare,pas kaq kohe heshtjeje?

-Si shkon marredhenia me mikun tend,me fal ish-mikun?

-Nuk kam marredhenie me te,rralle pi ndonje kafe.

Kam ngrene edhe nje dreke kujtim-sqarim.

-Une tani jam ulur vetem ne kafe dhe po pres te vije mikesha ime.

-Mikesha jote e castit ne tetor,apo ke ndryshuar cast e mikeshe?

Heshtje...

-Nuk ke deshrie te pergjigjesh?Te pelqen vetem te pyesesh dhe te mbyllesh celularin,pastaj,kur vjen radha jote,te shpjegohesh?Pse kerkon vtem nga une shpjegime?Nuk te duket se je ti problemi,jo une?

Heshtje...

-Celulari yt vazhdon te jete i mbyllur.Si ngahere ti e gjen te panevojshme te lajmerosh para se ta mbyllesh.

Me mire mos e hap me fare!

Heshtje...

4.12.2002

ORA 21:00

I panjohuri-C'e kishe ate ton te inatosur ne mengjes?

Sapo more vesh qe u ktheva,ndjeve pushtet mbi mua!

Kuptova sa pushtet ke tek ai me te cilin je prej vitesh.Duket se ai ta paska ushqyer.Edhe ketu ndryshoj une me te.

-Une nuk perpiqem te kem pushtet.As di,as dua.

Dhe nje gje tjeter:ngacmohem kur me thua se po pi kafe me mikeshen tende.

-Kjo eshte nje e vertete jo me e re per ty.

-Por eshte nje e vertete e bezdisshme.Mua me ke treguar per mikeshen.Po asaj kur do ti tregosh per mu?

-Une kam guximin tim t'i them asaj:"Kaq ishte me ty!"Nese mendon ta zevendesoj per hir te se ardhmes,duhet te me kuptoje,ne mos sot,me vone.Une s'jam per marredhenie paralele,qe te detyrojne te vihesh ne rol.Ti jo?

-As mua nuk me pelqejne rolet.Eshte gje e mire t'i thuash dikujt ne sy:"Kaq ishte!"Per fat te keq,kam pesuar marredhenie paralele dhe e di se c'do te thote.Nejse,mund te te bej nje pyetje?

-Edhe pyet?Jepi!

-Cfare nuk te pelqen ty tek une?Se cfare te pelqen nuk ia vlen te te pyes.

-Nuk me pelqen kur me fyen,nuk me pelqen qe marredhenien e shikon si perfitim te drejtash tek tjetri,edhe pse mund ta lendosh.Ti i ke cilesite

qe dua,por ke probleme me tipin,Ndoshta gaboj.

-Kur mesohesh me dike,te duket sikur ke edhe te drejta mbi te.Me fal,nese e tejkaloj te drejten time dhe te fyej.

Probleme tipi?Kam.Defekte,komplekse?Sa te duash.Njeri jam.Njeri qe reflekton here cilesi te mjedisit,here te partnerit,qofte edhe partnerit te dialogut.(Nuk po te fyej.)Rendesi ka thelbi,ai nuk ndryshon.Unë nuk jam vazja e '90-s apo 83-shit,por femija tek unë është e njejta me atë gjashtevjecaren qe dilte para psqyres ne kerkim te komunikimit.

-Vec teorive ti nuk permend asgje konkrete qe te na ndihmoje ne shpejtimin e takimit,qe thua se e kerkon me ngulm,apo ke ndryshuar mendje?

-Sa dua unë ta shpejtoj takimin,vazhdo te mos e vesh fare ne dyshim.Por dialogu është i dyanshem.Me pyet troc,te te pergjigjem troc.

-E vertete.Ne jemi hermetike ne pergjigje,ndaj pyetjet perseriten dhe pergjigjet shmangen.E kur e quaj teme-tabu,ti me korrigjon.

-Ne fillim unë dua te mesoj prej teje pse nuk me takon,por shqip ama,pastaj gjejmë bashke sepse-te e pse-ve dhe bejme qe takimi te afrohet.Mund ta bejme kete pa qene hermetike?

-Me shqip se kam folur nuk di te flas.Nese ti mund te komunikosh po kaq shqip,patjeter qe afrohemi,sic jemi shprehur se deshirojme.

-Mua me duekt se,sa me shume flas unë,aq me shume ti i largohesh takimit.

-Mos fol,atehere,por dije se unë nuk hyj qorrazi,i paftuar,as qe t'i prish pune tjetrit.Unë di vetem se je ndare,por jo pse-ne.

-Do ta dish patjeter?Pse te sherben?

-Nuk paske kuptuar asgje nga komunikimi.Unë s;jam kureshtar te di,ca me pak per ishin tend.Por pa ditur pse-ne e ndarjes,kurre s'do t'i lejoja vetes asnje hap konkret.

-E kam te veshtire te ta them.Eshte e veshtire.Arsyet e nje ndrajeje kuptohen nuk thuhet me dy fjale,ndryshe nuk kuptohen.Megjithate,s ite duash.duhet patjeter?

-Nese mendon se e thena na afron,pse vazhdon te ngurrosh?Aq me teper qe me the se ke pasur me te nje drekq sqrim-pajtimi.

-Thashe,nese me kujtohet mire,kujtim-sqarimi.Nuk e permenda pajtimin.

-Ti e di sa vendimtar është ky sqarim per afrimin tone,e prape ngurron.Po e mbyll me mire celularin per sot.

5.12.2002

ORA 8:30

Unë-Pi te vazhdon mire dita?Te te them dicka qe nuk dua ta mbaj per vete?Sa vrazhde e mbylle mbreme!

Kur dy njerez jane bashke,ne sms,ne tryeze apo ne shtrat,nuk me duket e mbare te ikesh me vrik.Dhe me duket se ti e ke zakon kete.Ti merr vendime per dy.E leme me kaq per verejtjet.Me merzite,por e harrova.Tashme e di kete defekt e efekt timin:harroj shpejt.

Tani e ke celularin mbyllur,por lexome kur ta hapesh dhe ndjeme,nese mundesh.

E di cili është problemi qe me pengon te flas.Unë nuk u ngjaj shume femrave

qe njoh e njeh ti.Kam qene shume e perfshire ne ish-marredhenien time.Nuk kam jetuar asnje dite pa te.Te mira dhe te keqija.Familja e tij me ka bere shume keq.Me ka perndjekur deri ne gjume,ndaj, kur nisi ky komunikim,dyshova se fshihte djallezine radhes te gruas se tij te frikshme.nuk dua te flas me gjate,por te kerkoj te me kuptosh dhe besosh:kam dashur,kam vuajtur,jam ndare dhe nuk jam e disponueshme te t'i them arsyet me sms.Me teper.Ai ka nisur,pas dy muajve qe nuk u pame fare,te me kerkoje te takohemi.Here-here pime kafen bashke.Thote se me do.Nuk e besoj dhe nuk e dua me. Mundesh te mos flasim me per kete teme?Une mendoj se marredhenia jone e mundshme nuk rrezikohet prej se kaluares sime,por nga menyra se si po ecen.E di ti qe une,ndonese te lutem te takohemi,kam shume frike. Nuk me ka ndodhur te jem kaq lakuriq dhe ne turp para nje njeriu per te cilin nuk di asgje.

5.12.2002

ORA 15:30

I panjohuri-Sapo i lexova;asgjen ga ato qe shkruaje nuk me vlen.Ja pse:

1.Unë,si shume te tjere,e dija se ke pasur nje lidhje,se ciles i je perkushtuar.Dhe per kete te veresoj.Por nuk mund te thuash se nuk e do me,mjaftohu me "nuk duhet ta dua me".Arsyen mos ma thuaj tani,po kur te takohemi.

2.Kur ai qe ke dashur te thote se te do,duhet te kesh arsye te forte te pohosh se ti nuk e do me.Per me teper qe per ate dashuri ke sakrifikuar as shume ne vite.

3.Unë nuk ta kam thene,por e njoh shume mire ate qe vazhdon te e doje me shume se une,pasi ka pervoje marredhenieje,te cilen une dua ta nis.Si mund te nderhyj une mes jush pa u sqaruar gjerat?Nuk dua te me cilesojne rrembyes,as te kem frike se do te ma rrembejne te dashuren time.Me mire nuk e hedh hapin ose e hedh ne kohen e duhur.Qarte?

4.Me foel per gruan e tij te tmerrshme.nje tjeter arsye per te besuar se jane pengesat dhe jo ndjenjat ato qe ju ndajne.Pra,s'ka vend per mua.Ai eshte terhequr taktikisht,por kurrresi perfundimisht.

5.Me vjen keq qe ndihesh e zhgenjyer nga ai.Te kuptoj pse tani ke nevojte per nje tjeter njeri.Unë nuk mund te jem ende ai me te cilin do te lidhesh seriozisht dhe pergjithnje.Hija e kesaj lidhjeje do te me turbulloje e xhelozoje ngahere,ndaj duhet te bindem se ajo i perket teresisht se kaluares.Keshtu me keshillon arsyeja.

Unë-TE keshilloka gabim.Nese mbarove,do te te rreshtoj arsyet e arsyeve te mia te ndryshme per te tuave,qe te bindesh se duhet te me takosh.

-Pse ne shtrengon te jemi kategorike?Te bejme si thua ti apo une,kur s'jemi ne nje mendim?Unë,nese te takoj,nuk kthehem prapa,ndaj e nisa udhen kuptoje.

-Ne c'kuptim nuk kthehesh prapa?

-Mos u hiq si naive?Por edhe mudn te jesh.Atehere po ta shpjegoj .....

-Mos u hiq naive?Por edhe mund te jesh.Atehere po ta shpjegoj:ne kuptimin

qe une kerkoj te ndertoj te ardhmen time me nje njeri si ti ose me ty,gje qe ti nuk e ke nder mend.

-Mos hidh fall per mua,ku e di ti ne dua a s'dua une te ndertoj te ardhmen time?

-Nese do to doje,nuk do te rrije me nje burre te martuar.Me mire po e leme,se do te nxehesh,nuk dua te rifutem ne temen tende tabu.

-nuk u nxeha dhe nuk dua ta leme.Por po vazhdojme vetem te gerricemi dhe keqkuptohemi.Mos na duhet nje strategji komunikimi?Fjale e madhe kjo per te thene se na duhet te ndertojme dicka te perbashket per te mundur dyshimet qe mua me vijne nga mosnjohja,ty nga njohja e gabuar.Nuk te duket se padurimi im per te te takuar vlen me shume se menyra se sa shtruar i ke marre gjerat ti?

-Me durim,jo me nxitim drejte asaj qe tani e kerkon vetem njeri.

-Durim?Deri kur?

-Fillove riciklimin e pyetjeve?Shenje se komunikimi po behet monoton.E mbyllim me mire per sot?

-E mbyllim.Ti vendos.Porta edhe jotja,topi gjithashtu:si mund ta bej une golin?

-Ndahemi tani.Mos harro se nuk ke vendosur ende te me thuash pse je ndare nga ai.E lame te ma thoshe pasi te takoheshim,por bindu sonte se kjo edhe thelbesore dhe do te na e shpjetoje takimin,ndaj beje neser.Do te jete me mire per te dy.Neser do te flasim gjate.

6.12.2002

I panjohuri-Mirembrema!Te lashe kohe per t'u menduar e vendosur,ndaj nuk te shkrova gjithe ditën.Besoj se mund te fillojme.Je gati te me thuash arsyen pse je ndare prej tij?

Une-Po behem gati te them.Do ta lexosh tani?

-Mos u hiq si e mistershme!Cilado qofte arsyeja,thuaje.Te jesh e bindur se kjo do te na afroje.

-Nuk besoj.Ty do te te duket e keqe,por po rrezikoj.Nuk eshte ndonje gje e jashtezakonshme,por me teper me vjen rende te ta them,ngaqe eshte e ngjashme me arsyet e sa e sa vajzave.Eshte krejt e rendomte.

-Thuaje,pra,se na vdiqe!

-Une i kerkova te martoheshim.Doja te kisha femije.Shume.Edhe ai.Beme plane bashke,dersia une kuptova se ai nuk kishe menduar kurre seriozisht per kete.Ai edhe sot thote se nuk ka genjyer,donte,por ishte e pamundur.Nuk e besoj.Kur nuk besoj,nuk jam "une",nuk jam.Patem ndarje graduale,madje disa ndarje,jo nje dhe menjehere.Kjo eshte me pak fjale.

Heshtje...

-E di qe mendon per mua si me te zakonshme e femrave tani.E mora parasysh kur ta thashe.

Heshtje...

-Ike tani?

-Nuk kishte ndonje gje te jashtezakonshme.Ti kishe te drejte ta kerkoje.Por tani me ler pak.Te shkruaj me pas.

-Mire.

(GJYSME ORE ME PAS)

Une-Mire je?

I panjouri-Jo.Kam dale jashte shtepise.Po shetis me kembe.Nuk me rrihet askund ,me askend.Dua t'i sistemoj gjerat qe me shkojne nder mend.Per mua je shume e mire,por e dija se te kishin "pronesuar" me pare te tjere.C'te bej?S'e di.Do te e shkruaj kur te mundem.

-Me tako mua,tani,te lutem.

-Sot kurrresi jo.Dua vetem te shfryj,jo tek ti,ndoshta tek ai.Dua te pi,te pi pafund.Nuk dua te komunikoj sonte me ty,mbase as nesor,asnjehere mbase.Deshtova.Pse nuk mbeta anonim i plote per ty,ashtu sic isha?! Shpresova dhe gabova.

-Ky eshte nje cast i keq,se per ty,ashte dhe per mua.Nuk di te te them ne eshte me mire te rri me veten:ti duek pire,e une duke u penduar,apo ta kalojme duke komunikuar.Por kam frike.Dhe ti nuk mund ta dish sa.

Heshtje...

-Mos pi,te lutem,mundohu te flasim bashke.Beje,eshte me mire,me beso.

Heshtje...

-Me beso vetem nje here.Shkruaj,se eshte me mire.Gjerat jane me te thjeshta ,nuk jane bardhe e zi.Do te bindesh nesor,por sot mos rri pa mua. Heshtje...

-Ti je burre dhe duhet t'i shohesh gjerat ne sy.Pse fshihesh pas pijes?Nuk eshte zgjidhje.Erdhem bashke deri ketu.Duhet e vazhdojme ose e mbyllim bashke.Mos me ler vetem tani.

Heshtje...

-Eshte i gjithi faji im.Falme.Nuk duhej te ta thosha kaq troc se me te doja te martohesha.Dhe ti me gjykon tani.Por duhet te mendosh me mendjen e nje gruaje,jo te nje burii.Eshte krejt ndryshe.Ne ne cdo marredhenie shohim burrin e ardhshem.

Heshtje...

-Celularin e ke ende hapur.Pra,po me lexon dhe nuk je i sigurt nese do apo jo te flasim.Thuaj dicka,se po pi dhe nuk do te te caj koken.Lendome,nese te ben mire,por thuaj dicka.

-Me fal.Nuk lexova asnje nga sms-te qe kishe derguar.I fshiva,gati instiktivisht,S'di se si.

-S'ka gje.Me mire,madje.Ishin budallalleqe.Lutje bezdisese.Si je ti?

-Une jam rrugeve.

-Po bie shi.

-E pastaj?Une rrugeve do te rri sonte,nuk dua te shkoj ne shtepi,e kam vendosur,do te pi,vetem se s'kam vendosur ende ku te shkoj te pi.

-OK.Bej si te jete me mire per ty.Per m,ua bej vetem dicka.Kur te arrish ne shtepi,dergo nje sms bosh qe te mesoj se je mire.Do te pres.

7.12.2002

Une-Miremengjesi!Mund te te shkruaj?

I panjohuri-Ti pret te te jap leje,apo te te them se do te pergjigjem?Te dyja i ke me pashe,qe kur nisem komunikimin.

-Mora leje ,se nuk erdhi sms bosh prej teje mbreme,sikunder ta kerkova dhe nuk dija ne ishe zgjuar ende.

-Jam zgjuar dhe kam ne koke vetem nje pyetje:cfare bisedon ti me ate,kur takohesh keto kohe?

-Oh,si qenke zgjuar ti!Nese ke fjetur...Te thashe se takohemi shume rralle.Nuk ka shume komunikim,me teper inerci bisedash.As per pune,as per dashuri.Pime vetem kafe dhe kaq.Me thuaj cfare te shqeteson?

-Qe menderisht ia ke pare hairin,qe e pi kafen me te dhe per inerci vazhdojne temat me ate qe nuk di te komunikoj me ty per gjera te tjera,se vazhdon te te doje shume.

-Nuk kam thene kurre se ai vazhdon te me doje shume.Ai me ka dahsur shume,te pakten keshtu besoj dhe vec kesaj ka qene miku m me i mire.Mbetet i tille.Per mua.Per te do te mbetem miku derisa te jem vetem.Po mesoi se do te kem lidhje,nuk di si do te reagoje,mbase dhe armiqesisht.

-Me habite.Si qenkeni vetem miq,kur ke frike te hysh ne lidhje tjeter?Ai te dashka te mbetesh vetem e tija.Ndryshe nuk dihet c'do te beje me ty dhe me mua.

-Do te na vrase,nuk e di ti?Pse behesh tragjil!Une nuk kam frike prej tij te hyj ne nje lidhje tjeter.Ne fillim m'u desh te mesohesha me idene e ndarjes,pastaj u mesova me vetem dhe mandej prita qe dicka te me ngjate interes.

-Ty te kuptoj,por jo ate.Ai te do vetem per vete dhe nese edhe keshtu,pse e ka te pamundur ta realizoje?

-Se te realizosh nje marrredhenie,duhen dy veta.

-Ti sikur flet me nje femije!Ju duheni,po meqe ishte e pamundur,ti me thua se nuk e do me dhe jeni vetem miq.Perralle!

-O Zot,nuk eshte perralle!Tek une ka mbaruar dashuria dhe egoizmi:tek ai nuk di cfare ka me hume:dashuri apo egoizem?

-Me fal,por per mua del ti fajtores,nese nuk qenka perralle.Ai vazhdon te te doje,ndersa ti jo.Ndonese e takon,por vetem si mik.Una nuk e besoj,si edhe cdokush tjeter.

-Ke provuar te duash,ke provuar te ndahesh,ke provuar te harrosh?Jane ndjenja qe levizin bashke.

-Po,kam provuar,ndaj nuk e pranoj si e kombinon ti harresen tende me dashurine e tij,kur rrini bashke te dy.Absurditet!

-Po ku dreqin rrim bashke!E di cfare do te thote te rrish bashke?

-Ma the ti:pi kafe,bisedon tema inerci,ndoshta jo veprime per inerci.Kaq mua me binden per cka thashe.Ty jo?

-Veprime?Nuk bej dashuri me te,ne te gjitha kuptimet nderkombetare te fjales.Nuk...nuk... nuk.Tani me duhet te largohem,se,sic e ke vene re,une jap edhe lajmet ndonjehere,pervecse komunikoj me ty.

-E kam vene re dhe me shume vemendje.Do te e shoh tani.te vafte mbare!Do te te dergoj sms pas lajmeve.Neser flasim per te tjerat.



(Pas lajmeve)

-Ishe shume mire sonte.Nje dekolte e shkelqyer.Eksituese .

-Oh,me ne fund nje fjale e mire!

-Mos bej sikur nuk degjon shpesh fjale te mira!

Dashamires duhet te kesh shume.

-Mendoja se kishe vetem dy:mua dhe ate.Sa te rrosh,do te mesosh.

-Obobo,me ngaterrove!Nuk thashe xheloze ne dashuri,e kisha per profesion.Ti do te me cmendesh!

Me duket sikur po perjetoj skenat e hetuesise se filmave te luftes.Lakuria dhe nje pike uji e nxehte qe bie mbi koke kohe pas kohe.

-Nese te dukem si hetues,iki;nese pranon "tortura" per mua,do te te shkruaj serish neseser ne mengjes.

08.12.2002

I panjohuri-Si me quajte dje,hetues?He,si thua,je dakord me "torturen"?

Une-Po,por te shkruaj pak me vone.Te lutem me fal,jam ne nje takim.

-Me ate?

-Pa lidhje.Jam ne takim pune.Te shkruaj sa te mbaroj.

GJYSME ORE ME PAS

Une-Sapo mbarova.U merzite?

Heshtje...

-Ku je?Kur do me shkruash?

Heshtje...

-Cili ehste celesi,fjala magjike qe e hap kete celular te mbyllur?Nuk di c'emer t'i ve inatit tend.Te thashe se isha e zene dhe do te te shkruaj sapo te mbaroja.Mbarova,sapo.Ishte teresisht nje takim pune.Vertet,nuk genjej.

Heshtje...

-Si nuk munde te me besosh asnjehere?Cfare njeriu je ti?

Pse sillesh keshtu?Kush te ka bere keq,kush te ka gjenjyer kaq fort,sa ti nuk beson me askend?

Heshtje...

-Tte kam inat kur e mbyll celularin!Dhe kam nje pergjigje te kreq ne koke,por po e le.Nuk do te sillem si ti.Do ta mbyllesh?Mbylle,por thuaj pse me pare,qe te me clirosh edhe mua nga kjo histori,ku u perfshiva emosionalish dhe menderisht.

I panjohuri- Emocionalisht? S'me duket, perderisa emocionet i harxhon me te. Apo i ke me shumice?

- Ah me ne fund! Nuk isha me te. C'te ben kaq te sigurt, apo me ndjek?

- Pra nese do te te ndiqja, do ta verifikoja se kisha te drejte per cfare thashe?

- Mos provoko kot. Dhe me ndiq, nese do te bindesh se kam nje marredhenie te mbyllur. Fare. Fare. Dhe nuk provoj interes per askend, pervecse per nje te panjohur, me te cilin kembengul te takohem.

- Marredhenie te mbyllur e quan? Ne mos e takove sot, e ke takuar dje, do ta takosh pasneser. Nuk eshte marredhenie e perfunduar.
- Po c'te perfundoj me shume se kaq? Do qe te mos e takoj fare, as per kafe? Mire. E bej. Po ti c'do te besh per mua pastaj, do te me takosh?
- Te te takoj? Dhe ku te shkoj pastaj, kur te rindizesh nga cdo kujtim i tij?
- Po c'di ti per mua? Duhet te me takosh, qe te bindesh se nuk rindizem nga gjerat e fikura. Po ti s'je "une" qe te me kuptosh. Po te ishe, me e pakta do te me takoje, me e pakta.
- Jo, kam frike.
- Frike nga se? Mos ai, me ta marre vesh, kthehet dhe me ofron ato qe s'me dha dikur? Por une nuk po i bej presion. Une jam ndare. Dhe jo me "gjoja". Ndarja eshte e rendesishme sa dashuria.
- Sa e sigurt je se nuk kthehesh pas?
- Si te mos jem? Cdo gje ka kohen e vet. Nuk mund te duash te njejten gje ne kohe te ndryshme. Me e lehte eshte te duash gjera te ndryshme ne te njejten kohe, sic ndodh me ty p.sh.
- Si mund ta dish ti c'ndodh me mua?
- E marr me mend. Ti ke nje marredhenie, qe e quan kalimtare, komunikon me mua per ate qe e quan "te ardhme" dhe me siguri ke nje marredhenie te se kaluares se afert, qe te ka shkaktuar shume pasiguri, madje me duket se ti me peshon edhe mua me kutin e problemeve qe duhet te kesh kaluar. Mos e bej! Nuk ka dy femra te ngjashme, as dy marredhenie.
- Analize e mire, i je afruar se vertetes, aq sa po me detyron te te pohoj se kam pasur para pak kohesh nje marredhenie te persosur.
- Sa mire! E paske provuar marredhenien e persosur. Une nuk munda.
- Ke arritur aq sa ke kerkuar. Nese ne dashuri ndiejne te dy, preket marredhenia e persosur.
- Nuk me duket perkufizim i sakte. Ne ndienim te dy, por nuk jemi me bashke, ndaj nuk mund ta quaj te persosur ish-marredhenien time. Por as ish-marredhenia jote nuk me duket e tille, nese nuk je me me te. Edhe dicka: nese do te takohemi ndonjehere, nuk do te doja te dija asgje per te kaluaren tende. Une do te pyes shume, por ti mos e lejo veten te me japesh ndonjehere pergjigje. Ky eshte nje sekret-sugjerim.
  
- Pse? Nese do te takohemi dhe do te lidhemi, mendoj se e kemi per detyrim, madje edhe kusht. Gabohem?
- Une, po te mesoja shume per ty, sa me shume do te lidhesha, aq me keq do te ndihesha. Do te beja interpretime, krahasime. Do te te merzisja ty dhe veten. E kam provuar ne marredhenien qe shkoi. Dyshime, pyetje, xheloz, makthe, sherre te semura, aq sa me thoshte shpesh se une hiqesha si gruaja, ndersa gruaja si e dashura.
- Ndersa une, duke ditur se tjetri nuk ka jetuar e boshllek para lidhjes me mua, do te doja ta mbushja me gjera te ndodhura, jo me fantazma.
- Nese ti nuk je si une, por me racional dhe i vetesigurt, mund te me pyesesh per gjithcka e te mesosh cfaredo prej meje nje dite. Por une nuk

jam racionale. Jam kureshtare, jam edhe e kompleksuar.

- Edhe une jam i kompleksuar, sidomos kur mendoj se ate cfare i ke bere tjetrit me pare, mund te ma besh mua me vone.

- E c'i paskam bere tjetrit para teje? Ki nje gje parasysh: nese nje vajze a grua punon dhe eshte perjetesisht ne gare, nuk ka kohe, madje as deshire te beje ate cfare pasmendon ti.

- Mbase.

- Jo mbase, keshtu eshte me femrat.

- Fol per vete. Ka njohur aq sa per te mos ju besuar juve.

- Flas per vete, atehere, por edhe ti mundohu te perdoresh gure te ndryshem ne peshore, ose kujtohu se mos nuk kishin edhe aq pune per t'u marre ato vajzat qe ke njohur e te kane shkaktuar kete pasiguri qe terheq pas vetes. Me duket se vajzat deh djemte, grate dhe burrat tradhtojne per te vrare kohen. Mua koha me duhet.

- Po me nje qe te tradhton per te vrare kohen lidhesh ti?

- Po ta di qysh ne nisje se eshte e tille, nuk lidhem. Me terheq besnikeria, po nese e kuptoj rruges dhe nderkaq e dua, mundohem t'i permbahem parimit: jeta eshte jotja. Bej c'te duash me te, vec ma thuaj. Tani, fare-fare keshtu nuk jam, se formen e kam moderne, brendine demode, por perpiqem, ose me mire kam perpjekur te jem e tille.

- Shkruan sikur e ke provuar te jesh e tradhetuar.

- E kam provuar.

- Ai te tradhtonte? Edhe ty? E pamundur! Me ke?

- Me ka tradhtuar. Ma pohoi ne ate qe une e quajta "dreka sqarim-kujtimeve". I kerkova te ishte i singerte pas viteve qe kishim kaluar, ne kisha qene e fiksuar apo kisha pasur te drejte ne dyshimet e mia. Ia kerkova me kembengulje dhe m'i pranoi.

- T'i pranoi? Pse, kane qene disa" M'i trego, cilat kane qene keto lavire?

- Oh, "lavire"?! Nga e rremove kete fjale? Ato jane ca gjysme-gra, qe mendoj se me teper shkonin me te dashurin tim sesa me te.

- Ta benin per inat. Dhe ai e dinte? Dhe shkonte me to?

- Jo, nuk eshte krejt keshtu, nuk kisha njohje te drejtperdrejte. Ndoshta edhe nuk kam te drejte ne arsyetimin tim, por me duket se te femrat keshtu funksionon: shohin nje femer, e shohin perdite, i ngacmon qenia publike e saj, parfumi, roza e saj e buzeve, i dashuri i saj dhe duan ti kene te gjitha c'ka ajo, qofte dhe per nje nate, apo per nje ore. Per te mos folur pastaj per nje marrredhenie te tij me nje te shkuar te tejshkuar, qe na ndoqi, ca per tradite ca per meshire. Po ate e takova vet.

- E takove? Cfare i the? Me c'te drejte?

- Me te drejten qe te jep dashuria. Ndaj shkova dhe takova vajzen qe me ndiqte neper dyshime dhe e pyeta shume hapur.

- Po ajo cfare te tha?

- Kush e mban mend! Kishte dicka shume anonime ne veshtrim; veshtrimi i dallon njerezit me shume se ngjyra e syve. Ajo foli e foli, po une sa kureshtare isha, aq bezdi perjetova ndersa e shihja tek me rrinte perballe si nje mase mishi e nenshtruar, e frikesuar se mos une i rrefeja tjeterkujt

qe ajo kishte pasur marrëdhënie me një burrë të martuar. E pazonja të mbronte veten, e pohonte se e kishte dashur dhe ndoshta e donte akoma.

-Po të tjeret për të cilat mesove me pas, i takove?

Cilat janë?

-Jo, nuk i takova. M'i tha vone. M'i tha kur u ndame.

Madje, për këto e falenderova. Nëse do të m'i kishte thënë kur e doja shumë dhe dyshoja shumë, do të isha cmendur nga poshtërimi. Tani nuk ka vlerë asgjë. Aq me pak ato.

-Po ai pse e bente këto? Nuk i mjaftojte ti?

-Kjo është një pyetje për të cilën ju burrat keni përgjigje të ndryshme nga ne gratë. Dhe unë nuk mund t'i di deri në fund arsytet e paarsyeshes së tij. Ndoshta ngase janë gjëra që thuhet vetëm mes burrash e jo mes ish-te dashurish.

-Ti vete çfarë mendon?

-Unë mendoj se kishte komplekse të pashëruara në femijëri, nga rritja, ai i perket një brezi tjetër jo timit.

Ka jetuar në kohë tallonash. Ti jo? Nuk ke ti komplekse?

-Kam, edhe pse nuk dua të t'i pohoj kësaj lehtë.

-Me detyrohesh tani. Unë skhorva gjatë dhe rrefeva gjëra shumë vjetëra, që në fund të fundit, janë të dikujt tjetër.

-Do të flas, po jo sonte.

-Sonte, tani!

-Për sonte po të them vetëm se kam komplekse, që të të mos zhgënjesh kur të lidhem me ty.

-Pse di të më zhgënjesh? Çfarë do të më thuash e nuk di si? Thuaje, pra!

-Jo, di ta them. Të dua! Por dua të ta them përgjithnjë, jo për një cast.

-Si të erdhi kjo? Më bëjnë syte, apo sapo shkrove se më do? Ke qenë kësaj i kujdesshem deri tani. Nëse më do pse do të më zhgënjesh?

-Pse, s'ta pata thënë edhe pata thënë? Pse ky komunikim deri tani?

-Është shumë e rëndësishme ta thuash, megjithatë.

-Më ke eksituar këto caste.

-Më fal që nuk të përgjigjem dot në këto mënyra.

-Ku je tani?

-Në punë. U harrova këtu. Po të pres ty dhe sekretin tënd. Të lutem, thuama për se të iki, pse ke frikë se do të më zhgënjesh?

-Asgjë, thjeshtë kam frikë mos nuk jam në lartësi dhe duhur si mashkull, sidomos po të krahasoj veten me të.

-Pse, kush tha se ai është mbinjeri?

-Sa e thjeshtëve problemin! Them se e ke ndjere seksualisht në maksimum.

-Unë ndiej seksualisht kur të dua tjetër. E doja, ndaj e ndieja. Ti si ben që e di sa e ndieja unë seksualisht?

-A ke thënë se doje të kshihe fmejë me të? Nuk e mban mend sa keq u bera unë atë natë, kur ma shkrove këto?

-Femija shpesh edhe edhe prodhim i rastesise. Femije mund të prodhojë edhe një seks teknik?

-Ti e ke provuar seksin teknik?

-Them se jo.Nuk e kam pasur ndonjehere seksin qellim ne vetvete.Dhe di te them"Jo,falemnderit!"

-Por atij s'dite t'ia thoshe?

-Ate e doje.E doja shume.Nuk dua te te ngacmoj,aste te nervozoj,por keshtu eshte.Edhe ti ke dashur shume.

-Jo,nuk me provokon.Po,edhe une kam dahsur shume.Dike qe ishte e martuar.Ajo eshte ende,por them"ishte" se nuk jemi me bashke prej ca kohesh.Dhe pikerisht kesaj i ndruhem.Te dy kemi perjetuar maksimumin ne nje marrredhenie dhe maksimumi preket nje here ne jete.Mos valle nuk do te mundemi bashke?Ti nuk me njeh ende,por jam i sigurt se,kur te me njohesh ,do te me duash.

Ndersa une,qe te njoh e te dua,madje per tere jeten,kam frike se nuk do te mund te te fal e as ti te me falesh ate riperjetim emocionesh qe kemi provuar dikur.

-Po kush tha se duhet te kerkojme te riperjetojme?

Pse,nuk ka asgje te re mes dy te panjohurish per t'u provuar e ndare se bashku pa te kaluaren ne mes?

-Druaj se jo.

-Une druaj se po.

-E leme sic thua ti,pra.Shkruhemi neser.Naten,atehere!

-Mire e ke ti.Me le mua pa gjume tani dhe thua "naten"!Kesaj i thone lidhje logjike!Megjithate,naten e mire!

-Te kujtoj se ti me ke lene vertet pa gjume.Dhe te sigurj se sonte do te flesh.Naten!

-Me dashke vertet.Pa gjume te lene njerezit qe do.-Mos harro se pranove edhe vete se te ladhe pa gjume.

Atehere,i bie se me do edhe ti.

-Naten,prej verteti!

-Nuk do te perjgigjesh?

-Jo,naten!

-Naten,naten,naten,naten e mire!Dhe po te pergjigjem:po,une te dua.

-Po te pergjigjem dhe une,atehere:do te takohemi per Krishtlindje.Mos shkruaj asnje fjale me shume tani.

Fli!Naten!Te dua!Fort!

9.12.2002

Une-Miredita!Nuk jam e sigurt nese nuk je zgjuar,apo preferon ta nis une komunikimin ne fillim?Nese eshte e para,fli edhe pak:nese qendron e dyta,eshte dicka qe e bej me kenaqesidhe pa komplekse.

I panjohuri-As njera,as tjetra,eshte nje e trete,po nistem Tiranes.

-Po iken jashte?

-Jo,vetem sot,per pune,kthehem ne darke.Nuk do te iki jashte,sepse jam i intersuar te rri ketu.Ti edi me se do te merrem deri me 24 dhjetor.me qellim qe te jem gati te te takoj me 25.

-Oh,po,e di deri me 24 ti do te vijosh te hetosh per mua.

-Me duket e pamoralshme te komunikoj me ty si mbreme dhe nderkohe te hetoj per ty,ndonese te dhashe disa argumente pse me duhet ta bej kete.Pas takimit tone une nuk hetoj me per ty,ti mund ta besh per mua.

-Dje une jam frikesuar,kam fjetur keq dhe kam lene gjera te rendesishme pa bere sot,sepse jam pa humor.Mbreme avancuam dhe ti e le komunikimin ne nje pike premtuese per te mos vazhduar me sot.Ndaj kerkon heshtje?

-Sa nxiton drejte ekstremeve!S'ka gje,edhe e drejta jote.Nga une vec emocioneve te komunikimit nuk ke pesuar asgje tjeter.Perkundrazi,ke mesuar se nje njeri te dashuron dhe do te te takoje sapo arsyeja ta lejoje.

-Te te pyes per dicka?A ka ndonje mundesi,sado te vogel,qe te mos takohemi dot me 25 dhjetor?

-Po,eshte nje:nese arsyeja e ndarjes ka qene inati dhe kjo te ben te besosh se nuk e do me.I njoh femrat qe dashurojne thelle,dhe u largohem atyre.

-Pra,kerkon nje pakt logjik,jo nje lidhje ndjesore?

Atehere,pse me zgjodhe mua?

-Se do te zgjidhja nje,se je person publik,se me pelqen,se ke treguar qe i perkushtohesh atij qe dashuron,se ke nevojte per nje tip si une,se thua qe je e lire,se...etj.,etj.

-Nuk te kuptoj,nuk te kuptoj,edhe pse perpiqem.

Nuk kuptoj ne ke frike nga thelesia e ish-historise sime apo te ndjell ajo.Te te them edhe dicka?Une jam nje por per zemren.Cfare do te dhenash te mbledhesh per mua,do te jene krejt te paqena e te largeta me ato qe une ofroj,nese me njeh nga afer.Bota edhe plot femra e meshkuj te ceket,te gatshem te luajne role.Nese me zgjedh e me thua"Mos ndiej e mos me ler te ndiel,se nuk do te jemi ne lartesine e asaj ndjenje qe te dy kemi provuar ndonjehere",do te jete si te me vrasesh dhe te me vrasesh mua,do te thote ta lesh shoqerine pa njerin prej atyre gjallesave ndryshe...Mos qesh!

-Po qeshja vertet.TE dua shume,por tani do ta mbyll celularin,do te jem i zene deri ne darke.Te puth!

10.12.2002

Une-Miremengjes!Sa gjate me harrove!

I panjohuri-U ktheva vone mbreme ne shtepi.Edhe sot do te jem gjate gjithë dite i zene.Ti si je?

-Une?Si thua ti?Ne ankth.Me duket se nuk je kaq i zene sa thua,thjeshte perpiqesh qe ta kalojme ne heshtje kete periudhe deri me 25.

-Ki durim edhe ca dite!

-Durim!Sa fjale e poshter!

-Ki kujdes kur perdor fjale te tilla.Ose justifikoji me shpjegimet perkatese,pse mos i thuaj.

-E ke vene re sa ngaterrohemi e pengohemi me kembet tona per shkak te sms-ve jo ne kohen e duhur.Unë jam ngritur pa humor,ti je me ngut,e leme me mire,vetem pres te me shkruash sor,kur te lirohesh.

-Patjeter.Ciao!

10.12.2002

ORA 21.00

I panjohuri-Une u lirova per sonte.Pse mte the ne mengjes se ishe ne ankth?  
Per cfare mund te mesoj une?

Une-Nuk kam ankth per cfare mund te mesosh ti.Nuk te kam genjyer.Kam frike se i druhesh nje ish-marredhenieje publike.Shqiptar je,burre je.Ndjese,nuk dua te te fyej.Por me trem heshtja e ketyre diteve,qe mund te sjelle heshtjen e gjate.E parandiej dhe e urrej.

-Te siguroj se nuk do te kete heshtje te gjat,po te ekzistojte nje komunikim i qarte dhe i hapur mes nesh.Te me sqarosh para se te ikesh.

-Po perpiqem per me shume,besime dhe vetem nese s'do te jete e mudnur,kuptome.

-Te perpiqemi bashke,atehere.Nuk te njoh qe te te them me siguri ne je ti apo une qe humbas me shume.Pse nuk ma thua singerisht c'mund te te mbaj larg meje?

-Lidhja juaj me rezulton teper e forte.Shume ju dine te martuar.

-Ne fakt,ti i ke problem grate e martuara!...

-Ah,fillove te fyesh ti?!E leme atehere.

-Me fal,nuk dohej te ta kujtoja sekretin tend,por dreqi e mori,per timin flasim gjithe ditën!

-Une nuk kam ndonje sekret per te ndare,aq me pak per te ma kujtuar.Ta kam thene tashme se ajo nuk ekziston me,nuk patem mundesi te lidheshim dhe tani ajo eshte me burrin e saj,une me ty,per aq sa mundemi.

-Mundemi,mundeshim,do te mundeshim.Nuk me pelqen shume kushtoroja jote!Nese do dicka,mundesh qe c'ke me te!

-Ah,ti mundesh?Atehere,kur te gjithe e dinin se ai ishte duke u ndare,ose ishte ndare nga gruaja,si ndodhi qe ju nuk mundet?

-U terhoqem te dy,pasi ne janar ai mesoi dicka.Ma tha mua dhe tani jemi tre qe e dime:une,ai dhe e shoqja.

Nese ngulmon,mund te ta them,por une as di ksuh je ti.

Ose me mire po ta them,qe te mos pyesesh dynjane,qe nuk di gje,por eja me tako me 25.

-Nga ti,ose nga ai,ose nga dynjaja,une do te perpiqem te mesoj pse jeni ndare,nese kjo eshte e vertete.

-Do te vazhdoj?

-Nuk te detyroj,ca me pak tani qe nisa t'i mesoj vete ca te verteta.

-Mire.Zbuloje vete,atehere dhe pastaj perballim te vertetat tona.Vecm os harro se ka ca te verteta te cilat nuk kane arsye,kane zemer.

-Kete dua te qartesoj:arsyen qe i tha zemres sate qe te mos e duash me.

-Une mendoj se nje arsye qe te shtyn te mos besosh,eshte marredhenia jote e pamundur.Ti e do ende gruan e martuar per te cilen me ke folur dhe e takon sa here te jepet mundesia.Ti ke frike se mos ndodh edhe me mua keshtu.Ketu gabon.Une nuk jam ajo,ti nuk je ai.Marredheniet dhe njerezit ndryshojne.Kur e doje aq shume ate grua,pse nuk e more?Ke pasur,apo ka pasur,patjeter nje arsye te forte,me te forte se ndjenja.Me beso:do te kesh nje dite nje grua,cilado qofte dhe sidomos do te kesh fmeije dhe do ta harrosh ate.Une nuk e them dot me siguri ne me la ai mua apo une ate,por di te them se

arsyeja funksionoi;per fat te mire a te keq,ku i dihet.

-Te mos bejme krahisime ish-marredheniesh tani!Imja qihet nje marredhenie e paduhur.Ajo nuk duhej te prishte familjen.

Ajo nuk duhej të prishte familjen dhe ti e fale?E po unë nuk e fal,as e dua atë qe nuk me lejon te ndertoj familjen time.Qe kur isha fëmijë luaja "me shtëpia".Doja te rregulloja shtepine time,këtë kam enderruar gjithmonë,e nuk me shkon mendja të mos e realizoj.Unë urreja te isha dashnore,urreja fjalën "duro".Urreja te sillja ne jetë fëmijë qe do të luante "e gjen kush e gjen" nëpër shtëpi ne kerkim te babit,qe vjen here pas here e nuk rri kurrë gjatë.

Ka diçka qe ti duhet ta kesh kuptuar e nuk rri kurrë gjatë.Ndaj ti e humbe atë dhe ai me humbi mua.Nuk me mbeti me cep pa zbuluar,te lumte!

-Unë nuk kam qëllim te gerموj e zbuloj ne jetën tënde,dua vetm te jem realist ne dëshirën-ndjenjë qe kam për ty:ndryshe s'ke pse me thua asgjë,di vete si bëj.

-Ti s'do të gërmosh?Po ç'do të gërmosh ende?!

Unë edhe me veten nuk kam pasur mundësi t'i them të gjitha këto.

-Edhe unë vetëm me ty kam folur për sih-marredhenien time,ngase flasim me sms dhe ndoshta kjo na lehtëson intimitetin,ose ngaqë ti di si t'i nxjerresh gjërat.

-Çfarë kishte ajo te ngjashme me mua?

-Pse nga e kupton?

-Sepse ke gjetur patjetër ngjashmëri,kot nuk me zgjodhe pikërisht mua.

-Ajo është arkitekthe.Ajo...Nuk ia vlen të flasim për te,ajo... ishte.Rrime ne këtë qe po përpiqemi të ndërtojmë.

-Këtë jam duke te kërkuar dhe unë.Rrime te kjo qe po përpiqemi të ndërtojmë te dy,nuk ia vlen të merremi me ish-ish-ishat tanë.

-Po,e drejtë,por nuk mundem të mos ngacmohem sa here qe ti me thua diçka dhe unë mendoj diçka tjetër.

Ndaj me mirë t'i kalojmë ne heshtje ditet qe na çojnë me 25 dhjetor.Është me mirë kështu,me beso.Presim Krishtlindjet për t'u takuar dhe qartësuar.

-E ke vendosur vërtetë,asnjë komunikim deri me 25,as jashtë teme?

-Jashtë teme?Pse,c'na interesojne te tjerat jashtë teme?Ndaj me mirë të heshim dhe te mendohemi gjatë deri me 25,OK?

-OK,OK,OK,OoooooK

-Mos u mërzit.Të puth!

13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,23,24,12.2002

HESHTJE

\* 25.12.2002

\* Ora 13:14

I panjohuri- Përshëndetje! Dua te ta them qe ne nisje: nuk do të takohemi sot, as nesër, ndoshta asnjëherë. Por bëtë mirë qe komunikuam kaq idealisht, pasi gjetem te njeri-tjetri partnerin shpirtëror, qe nuk arrihem siç deshem - ta benim real e fizik, pasi ti ishte tashmë "ti" dhe unë isha



tashmë "unë"; te dy pasqyronim te kaluaren dhe te tashmen tonë me te tjerët, ndaj nuk u kuptuam, nuk u besuam, nuk...

Ky tip jam unë: inatcor si fëmijë, mendjemadh, qe dashuron me arsye e jo me ndjenjë, xheloz ne ekstrem, shkurt, burrë tipik shqiptar, sa modern ne dukje, aq arkaik ne thelb. Unë nuk arrita te te kuptoja e te te besoja se ti je vërtetë e lirë dhe e disponueshme për t'iu kushtuar një lidhjeje te re, jetësore, për te cilën unë ngulmova.

Më fal ne emër te asaj qe ndiejme për njëri-tjetrin, ndonëse nuk me pe kurrë e unë kurrë nuk te preka.

Me beso: te dua dhe do të te dua gjithnjë, kije parasysh këtë. Të uroj te gjesh një njeri shumë me njeri se unë, sepse e meriton. Dua të jesh e lumtur nga ç'do të te bëja unë! Paç fat!

Heshtje

- Shkruaj diçka, te lutem!
- Falemnderit qe me do! Falemnderit qe te dua!
- Mbase je e fyer, e zhgenjyer, por me kohe do të te kaloje e do të me kuptosh. Qofsh gjithnjë mirë dhe e mirë! Lamtumire!

\*31.12.2002

Unë- Jo se ke qenë me mua çdo edicion lajmesh, por sot qe nuk je fare, e ndiej fort. Me ty dhe pa ty iku dhe edicioni i fundit i lajmeve te këtij viti. Iku dhe ky vit. Tani dua te dal nga kjo dhome grimë, ku jam mbyllur me celes qe prej një cerek ore, te fshij pudren, rimelin, te kuqin e buzeve, te fshij lotet gjithashtu, te mbledh veten dhe te uroj për Vitin e Ri gjithkënd qe me del përpara, pastaj te iki. Por nuk di pse duhet ta bëj. Dua te shtrihem këtu e te me zere gjumi dhe te iki pasi te kenë ikur te gjithë, edhe roja e fundit, edhe qeni te dera, te gjithë, të mos shoh e të mos më shohë njeri. Jam e derrmuar. Nuk di as vete pse ia them këto një celulari te mbyllur, qe nuk do të hapet me për te me lexuar e shkruar, por duhet t'ia them dikujt. U bene shumë vjet, te rinj e te vjetër, qe ikin pa me bërë te lumtur! Mbase nuk është faji i tyre. Mbase e lumtur kam qenë vetëm atëherë kur nuk ia dija kuptimin fjalës. Atëherë isha e vogël dhe thosha me ze te lartë nëpër shtepi se i kisha kërkuar Babavitit te me sillte një cante doktoresh dhe naten e fundit, ndërsa rregulloja bredhin, canta gjendej krejt papritur dhe shtëpia mbushej me klithma gezimi. Pastaj dilja me babin nëpër qytet për të parë bredhin e madh te qendres te zburuar dhe i vertitesha e i vertitesha mos gjeja ndonjë dhurate tjetër. Ndoshta kjo duhet te jetë lumturia: të kërkosh pak e t'i gezohesh asaj qe te vjen, pa pyetur e pa dashur të dish se kush ta sjell. Ndoshta! Ndoshta kur pret shumë, nuk merr asgjë. Dhe ca me keq akoma, madje me keqja e te keqijave, qenka kur nuk do, nuk pret, nuk kërkon asgjë. Ja, si sonte! Sonte nuk dua, as pres gjë, madje as nuk di pse asgjene po e ndaj me ty!

\*31.12.2002

\*Ora 23:55

I panjohuri- Sapo e hapa celularin për te te uruar. Nuk doja ta mbyllja këtë vit pa te thënë asgjë. Ka qenë viti ynë. Por pashë se e kishe bërë para meje. Sapo i lexova mesazhet që me dërgoje. Të falenderoj, janë gjithnjë te mirepritura nga unë. Nuk te kam shkruar, pasi me dhe përshtypjen se ndiheshe hatërbetur me mua apo nga mostakimi ynë. Ne pamundesit për t'u lidhur ne jetë, parapëlqeva te mbetesha një mik i brendshëm shpirtëror yti, si askush tjetër, besoj. Me vjen keq që ndihesh keq. Me ty!  
Unë- Falemnderit! Ishte një dhuratë që nuk e prisja komunikimi i sotëm. Të uroj një vit te mbarë!

- Edhe unë ty. Të uroj 2003-shin, vitin e sfidës sate. Paç fat dhe realizofsh dëshirat-endrra që ke për te gjetur njeriun tënd te jetës dhe u plotesofsh ne profesion, ashtu siç do të doje!

- Edhe ti, edhe ti! Po ta them sërish: u gezova që me ishte pranë sonte dhe me shkrove, por nuk mendoj se do të na vlejë e sherbeje te shkruhem sërish. Ndoshta sonte ishte hera e fundit. Lamtumire!

- Lamtumire, zemër!

JANAR 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12

HESHTJE

13.1.2003

I panjohuri-Si je?

Une-Keq,per dreq!Ti nuk mund ta marresh me mend sa u drodha kur pashe sms-ne tend.Kam pritur qe nga 31-shi.

Vete te thashe te mos shkruheshim me,por megjithate prisja.

-Falemnderit per ndjenjen e shprehur per pritjen e gjate dhe me ankth te sms-ve te mia!Edhe mua si ty me ka ndodhur,packa se jam permbajtur.Jam frenuar,pasi ti 2003-shin do ta shfrytezosh per te finalizuar marredhenien premtuese te nisur me pare.

-Falemnderit qe dole mbi vetepërmbajtjen tende!E vetmja gje qe dua te finalizoj kete vit,eshte takimi me ty.

Dua te te takoj,miqesisht,ose detyrimisht,ose seriozisht,ose si te duash ti.Por une dua te te takoj.Ti si thua?

-Miq ke,te dashur ke,mua per se me do?Une do te takoj nese nuk do te kisha shprehur ndjenjen,e cila mbeti aty ku nisi.Atehere,pse me propzon te takohemi?

-Pyetja nuk shtrohet pse dua te te takoj,por pse do ti.Eshte kaq normale ajo qe te kerkoj.Cfare te pengon ty?Nuk kerkoj impenjim,vetem te te njoh dhe te flas me ty nje pasdite.Nuk arrin ta kuptosh se dua te te njoh?

-Te kuptoj,por nuk te jap te drejte.Edhe dicka:ti ke folur me te per sms-te tona dhe kjo edhe nje tjetër arsye qe me detyron te te mos takoj.

-Po me thua se kam folur me te per sms-te tona?Dhe nese e kam bere,c'problem perben kjo per ty?

-Tani asnje problem,por vetem se nuk ke qene e singerte me mua kur me thoshe se ishe ndare.Fale arsyesh,nuk gabova.  
vazhdon .... tani ika sepse nuk kam kohe me shume shihemi

- Pse bëjmë lodra fjalesh? Ti pranon se je frenuar te me shkruash, domethënë do të doje. Atëherë, ti do të me takosh, thjesht vetefrenohesh. Kam te drejtë? Ti do të me takosh?
- Nëse do të ishe e lirë. Ti je për marrredhenie paralele, unë jo. Ndaj s'ka kuptim te te takoj. Dhe vetepermbahem. E qartë besoj?
- Unë nuk genjeva. Isha dhe jam ndare prej tij, ne gjithë kuptimin e fjalës "ndarje".
- Nuk ia vlen të merremi me këtë, por te kujtoj se vete ke thënë se mbetet miku yt; aq mik, sa i flet dhe për sms-te tona etj., etj.
- A mund ta di se si mund të bindesh ti? Çfarë te bëj qe te te bind se unë me këtë njeri nuk takohem me, fare, nuk kam marrredhenie/
- Asgje, kur nuk mundem me gjithë ato mesazhe, nuk mund te besoj ne sinjeritetin tënd. Ti me dashje kapercen gjithçka qe nuk te intereson.

\*14.01.2003

Unë- Miremengjes! E mbylle dje pa e mbyllur.

I panjohuri- E mbylla sepse me merziti qëndrimi yt i skajshëm. Anashkalon thelbin esms-ve te mia, duke penguar komunikimin qe kërkon.

- Unë nuk kerkoj komunikim, kerkoj takim. Unë dua te te takoj ty, dua te te takoj. Ndoshta tani, ose nesër, ose pasneser. Kur të duash.

- Pse, qe te me njohe edhe i dashuri yt? Kështu qe vazhdojme komunikimin, por pa me bërë presion për t'u takuar.

- Nuk e di ne ia vlen ta nisim komunikimin nga e para. Qëllimi i gjithëkaje ishte te te takoja me 25 dhjetor. Nuk e bëtë. Kam qenë keq, sidomos pas sms-ve te 25-s dhe 31-shit. Vendosa të mos komunikonim me. Por nuk e permbaj dot veten. Tani kam te njëjtën kenaqesi si vjet, qe s'di ku do të me çoje. Ti nuk do të me takosh dhe unë nuk di si te te bëj te vendosesh. Sms-te nuk mjaftojnë për t'u sqaruar dhe nuk do të na çojnë asgjekundi, as mua, as ty. Nuk di çfarë po me ndodhë. Jam rremuje, më pak fjale: kënaqem kur më shkruan, por kam frikë.

- Mos ki frikë te me përgjigjesh. Lulatjet e tua me largojne. Nuk jam unë pasiguria, por ti.

- Jo, nuk jam e pasigurt. Jam shumë e sigurt se e vetmja gjë qe dua, është te te takoj. Po pres qe ti te sqarosh pasigurite e tua. Do ta besh? Unë nuk dua te nis e t'i tregoj historite nga e para. Jam krejt e singertë ne gjërat qe te kam thënë dhe te them. Dua te te takoj, te te njoh. Është krim? Rrime një pasdite bashke, flasim. Flasim sërish. Takohemi te nesërmen dhe flasim. Nëse nuk ecën, nuk flasim. E di si sillesh ti? Sikur, po të takohemi, do të te çoj për dorë ne kishe. Jo, o njeri, do të takohemi, do të hame ose jo dreke bashke, do të flasim dhe kaq. Mos u tremb.

- Falemnderit qe me jep zemër mua frikacakut! Nuk je për mua grua e tmerrshme, por heperhe nuk je ne te njëjtën gjatesi vale me mua. Ia lemë

komunikimit me smsose kohës. Zgjidh ti.

- Unë te kam zgjedhur. Dhe nuk besoj se do të me kesh edhe për shumë kohe peng.

- Vazhdo, duke te uruar qe te besh zgjidhjen me te mirë për vete, jashtë meje. Unë s'mbaj njeri peng.

- Por po me mban mua peng! Me tako, pastaj te tjerat ia lemë kohës, arsyes. Nuk kemi si te komunikojme ne kushte te pabarabarta. Nuk është e ndershme.

\*15.01.2003

Unë- E nderpreve sërish dje komunikimin.

I panjohuri- As ti nuk m'u duke se ishe gati te vazhdoje. Mu duk se ishe e zënë. Nuk dua te te ve ne pozite te vështirë qe te komunikosh me mua kur je e angazhuar, por dhe nuk me pëlqen te niseshe kur lirohesh nga...

- Kontrolllo parandjenjen. Unë jam e lirë pa fund te te shkruaj. Nëse e bëj rrallë, kjo ndodh ngase kemi një komunikim ende te pastabilizuar, jo pse nuk dua, as se jam e zënë me...

HESHTJE

\*15.01.2003

\*Ora 24:00

Unë- Po të them nate, edhe pse e ke mbyllur celularin dhe nuk do të ma kthesh përshëndetjen. Çfarë nuk po shkon? Na kishte marrë malli te dy për te folur dhe nuk flasim. Ç'do të bëjmë? Tani e kam mësuar: ty është e kotë te te imponohesh, maksimumi mund te te prek, por në fund bën siç do vete. Ndaj, te lutem, m'u pergjigj kur te hapesh celularin, te lutem. Ç'do të besh? E nise, e mbylle, e rrifillove (ndoshta). Po tani?

\*16.01.2003

I panjohuri- Miremengjes! Sapo u zgjova. Mbreme jam kthyer vonë. Këtë fillimviti jam i zënë me lidhje kontratash. Ndoshta bashke duhet te bëjmë "kontraten e komunikimit".

Unë- Miremengjes! Nga mesazhi yt u zgjova. Këtë vit e kam nisur me shumë gjume. Dakord për kontraten e komunikimit. Vetëm ma shpjego.

- Pika kryesore: pa hatermbetje ne çdo rrethanë. Shkruhemi vetëm për tema qe te dy duam t'i diskutojmë. Ndryshe e nderpresim pa te drejtë rifillimi. Dakord?

- Kur nenshkruan një kontrate, percakton kohën. Vendos një date-kufi për takimin. Ai është qëllimi, te paktën për mua.

- Do te ishte paravendosje, qe do të na detyronte te ishim ne pritje te tij, ndërkohë qe takimi mund të vijë natyrshem, shumë me pare. Ndërkaq ti je e lirë dhe pa asnjë detyrim ndaj meje. Kjo deri ditën qe do të takohemi. Mandej lidhja jonë varet vetëm nga ti. Kjo do të thotë se, në rast se te takoj, unë jam i bindur dhe pastaj mbetet të bindesh ti se unë vlej për ty

po aq sa ti për mua. Të ndihmojme njëri-tjetrin me sinqeritet për të ardhmën tonë.

- Nuk di sa do të mund të vij ne ndihmë ty dhe vetes. Duhet të me kuptosh. Jam unë ajo që ecën në errësirë, dhe ti nuk më jep asnjë dorë.
- Je shumë e ngutur, e di këtë?
- Po nguti nuk është faj, është dëshirë.
- Ah, ti po që e çon gjuhën ku të dhemb dhëmbi dhe i stis fjalët si të të interesojne.
- Nuk do të të shkruaj për ca kohe, pasi do të jem në një varrim.
- Besoj e shpikë këtë.
- Jo, jo, vërtetë, varroset vella i vogël i një mikut tim. Vdiq rastesisht. Rastesia është fatale, të merr e të jep gjëra që kurrë s'i kishe menduar.
- M'u bërë si mesuese tani! Ik ku ke për të vajtur dhe më shkruaj sapo të mbarosh.
- Mirë.
- Je e mirë. Sikur të ishim takuar dhe miqësuar me parë! Sa bukur! Sa larg! Sa keq që jemi marrë me të tjerë! Tani do të flisim për problemet e fëmijëve tanë e nuk do të benim vete si fëmijë. Ik tani, shkruhem me vonë.

\*16.01.2003

\*Ora 18:00

Unë- Mbarova, jam e lirë tani. Po ti?

I panjohuri- Edhe unë mbarova pa mbaruar punë. Pse është e vështirë për ata që duhen të sillen siç ua do shpirti, pa gerveret e tipit/

- Është e vështirë, sepse ata që duhen nuk janë indiferente ndaj njeri-tjetrit. Grinden në kerkim të komunikimit të përkryer. Nuk është gjë e mirë, por shumë me e mirë sesa ata që nuk duhen, që as flasin, as kërkojnë, as japin, as marrin, e kështu që nuk kanë pse grinden. Nuk ke parë cifte në bare, restorante që përtojnë dhe të shihen në sy? Shkembejne fjale vetëm për të kërkuar vajin a kripen. Mendo c'ndodh me ta në shtëpi a shtrat! Ndërsa kjo që na ndodh neve, ka të bëjë me mënyrën që kemi zgjedhur për të komunikuar. Kjo na e vështireson edhe me shumë lidhjen. Ti nuk më beson, por do të ishte me e lehtë sikur të njiheshim të dy. Unë nuk do të isha kaq nervoze dhe e ngucur. Pa dyshim do të toleroja me tepër. Edhe ti, pse jo?
- Do të doja të dija si e vlerëson ti veten dhe partnerin: sa e do, pse e do, sa e toleron, sa kërkon të të toleroj?
- Këto janë gjëra me të ndier, jo me të shpjeguar. Unë në përgjithësi jam njeri i ftohte, dua pak njerëz, por me gjithë shpirt. Zhytem në dashuri, aq sa nuk pyes për arsyet. Toleroj. Në përgjithësi nuk më bëjnë përshtypje gjërat e vogla, por as të medhate. D.m.th jam një cike kot. Merzitem shumë, por nuk largohem pa gjetur pse u merzita. U shkoj pse-ve deri në fund, dhe kur kam mbaruar së foluri, më ka ikur merzia. Të nesërmen nuk më kujtohet aq që bëra fjale. Nuk di të të them me shumë. Po ti?
- Unë jam ndryshe. Dua shumë, por nuk fal. Unë nuk ia fal vetes të takoj

një femër, edhe pse e dua, pa u bindur se ajo nuk e do me atë që ka dashur. Aq me tepër që...

- Qe?

- Qe unë e njoh atë. Është rregull mes meshkujsh që të mos ngaterrohen me te dashurat e atyre që njohin.

- Oh, prandaj në Tiranë të gjithë shkojnë me të gjitha?!

- Ah, fillove ti me përgjithësim?! Nuk më duhet fare c'bëjnë të gjithë e të gjitha në Tiranë. Me duhesh ti dhe unë. Dhe ai më intereson, kuptohet.

- Si e ke emrin?

- Do ta mesosh edhe emrin, po kur të vendosim të takohemi.

- Unë kam vendosur. Ti po humbet kohë.

- Nuk e quaj kohë të humbur, përkundrazi. Nëse për ty është e tillë, e nderpresim komunikimin, ia lemë kohës.

- Nuk dua të me kercesosh sa here të kerkoj të takohemi. Ti e di që tashmë u jam nënshtruar kushteve të tua, por nuk parandiej asgjë të mirë. Unë njerëzitë i ndaj në ata që i njoh, nuk i njoh, i dua, nuk i dua, u besoj, nuk u besoj. Ku të të fus ty? Nuk të njoh. Emrin në celular ta kam shënuar "I panjohur". Një here në dy sms me kap paniku mos je grua apo mos e bën këtë komunikim për llogari të tjetërkujt. Por vazhdoj. E di pse? Sepse e vetmja gjë që kërkova në kishe për Krishtlindje, isha të të takoja ty. Me beso me intuite. Do të vijë koha që do të me njohësh e do të me besosh me logjike.

Heshtje

- Nuk do të me thuash asgjë? Ti ma njeh ankthin kur vonon çdo sms e jotja. Ndoshta je i zënë, por mua me duket se thashë diçka që te preku dhe ti reason duke heshtur....

- Vertete me mendon here grua, here detektiv, here ku e di unë çfarë dhe prapë me kërkon? Cuditem me këtë spekter ankth-dëshirë që perjeton! Me vjen shumë keq. Më fal. Më duhet ta zgjidh. Do të mendoj se si. Nesër të jap përgjigje. Për sot me mirë ta mbyllim. Nuk duroj dot të me perfytyrosh dhe shperfytyrosh deri në grua! Diçka ende të mundon.

- Po i mendoj të gjitha, por është me e fortë dëshira për të vazhduar. Nuk ka nevojë të me kerkosh falje. Mjafton të me takosh sa me shpejt.

- E vleresoj si ndjenjen, ashtu edhe ankthin. Por dije se unë jo rrallë mendoj që ti luan me mua, madje bashke me te. Ndaj jam i kujdesshem të shmang çdo konflikt.

- Ai për ne s'di pothuajse asgjë. Kaq të poshtër me di mua, sa të luaj kështu me ty dhe veten?

- Di se nga dashuria edhe njeriu me i mirë bën çdo gjë. Nejse, naten!

- Natën! Natën! Me beso një here mua dhe do të besoj pafund.

\*17.01.2003

\*Ora 07:20

I panjohuri- Miremengjes! Të zgjova? Më fal.

Unë- Jo, s'ka gjë. Me bën mirë te zgjohem herët, Po ti, pse kaq me ngut sot?

- Ne shtrat jam akoma. Doja te dija ne kishte fjetur mirë. Unë do të cohem tani dhe do të mbaroj ca pune, qe të flasim nga 12-a. Mirë?

- Mirë. Dite te mbarë!

17.01.2003

ORA 12:30

Une-Mire te shkojne punet?Kur te lirohesh,kujtohu per mua.

-I panjohuri-Pothuajse mbarova.Nese je e lire,fillojme.

-E lire jam,ne kuptimin qe nuk kam pune.Nese do te mbarosh gjerat e tua,shkruhemi pasdite;nese ke mbaruar fillojme qe tani.Por nese ke marre nje vendim,jam ne ankth ta lexoj.Mbrema kam fjetur keq.Me dukej sikur do te ndodhte dicka sot.

-Asnje vendim per te qene ne ankth,vec do te flasim troc.Fillo ti e para.Cfare ke ne adresen time.Pyetme qe te pergjigjem.

-Nuk kam ndonje gje pr te te pyetur.Ti e di qe une kam vetem nje deshire dhe kerkese:te te takoj.

-Po filloj une,atehere.Nese nuk do,s'te pelqen apo dyshon tek une,ma thuaj se nuk pergjigjesh.Por te lutem,nese vendos te pergjigjesh,beje sinqerisht,se me pas do te vuajme te dy;madje qysh ne takimin e pare.Une dua te saktesoj ato qe kam mesuar per lidhjen qe ti ke pasur e qe edhe tani disi e vazhdon.

-Po,dakord jam.Do te pergjigjem sinqerisht,duke pasur besim se,takohemi apo jo,keto do te mbeten mes nesh.Pyet hapur,te te pergjigjem hapur.

-Falemnderit,pasi e kuptoj pozicionin tend te veshtire.Por edhe mua duhet te me kuptosh pse ngul kembe ne kete teme:nuk dua ta ndertoj marredhenien time mbi nje te ngritur me pare nga dikush qe ti e ke dashur vertete shume...Por kjo tregon force karakteri.Eshte per t'u pasur zili.Nuk di ne do ta kem edhe une fatin e tij...

-Pyetme,pra!

-Pse e nise ate lidhje?Ti e dije se ai ishte i martuar dhe sidomos pse e bere publike?

-Ishim miq prej vitesh.Nuk ishte miku im me i ngushte,as nder me te afert,por kam ndare me te disa caste te deshperuara.Ndoshta per rastesi,e takoja ne dite te keqija per mua,ose mbase dhe e kerkoja ne dite te tilla,sepse ai me jepte siguri.Mbaj mend si tani nje cast kur po ecja me te buze Lanes.Ishe si e renduar prej nje problemi,per te cilin nuk doja t'i hapesha askujt dhe ndersa ecja krah tij,ndjeva se mund te mbeshtetesha tek ai.Kam pershtypjen se ajo sekonde,ai cast ecjeje me te permbloodhi gjithë ndryshimin mes miqesise dhe dashurise.A nuk thone se i ndan fare pak gje?E kapercen pa e kuptuar.Me pas,duke punuar bahske,dilnim pa problem ne publik.Derisa lidhja jone u mesua dhe une nisa te rezervohesha.Kjo ben qe ne njefare menyre te mos shijoja kurre te qenet cift.Aq sa me kapnin denesat tek vezhgoja makinat mbushur me cifte,qe dyndeshin ne Durres.Me

ngushellonte vetem fakti se te gjithë e kishin nje problem.E kush nuk ka? Une,per shembull,problemin me te madh kisha te dielat bosh.Ne Korce,nje dite gjeta nje ikone "Shen e Diela".Nuk di te te them sa e perulur u ndieva para saj.U mbusha me mornica qe nuk i kam provuar as kur i putha doren Papes.E kam prekur ikonën per minuta te tera,duke u lutur pa ze te me falte ca te diela per t'i shijuar jo vetem me gjume.Nese te duket se nuk u pergjigja,thuama.E di qe s'te pelqejne ato qe shkruaj,po kjo eshte e keqja e se vertetes:kerkohet,por s'durohet.

-Perjgigja ishte e singerte.Pra,nisi sic e nis shumica.

Por u be serioze,premtuese;perspektiva,deshira per femije,premtimet per ndarje,bashkejetesa etj.

-Nuk di si e ke vazhdimin,por ne nuk kemi bashkejetuar.

-A eshte e vertete se te ka share rende pas nje incidenti pak a shume publik qe i krijove?Interesohem per tolerancen tende ndaj tij.

-Ti e di vete ku do te dalesh,por nuk ke per te mesuar shume per mua duke u nisur nga marrëdhënia ume e shkuar.Eshte si te ndaloja une tek ish-historia jote per te mesuar so do te reagoje me mua nje te ardhme.Por do te ishte gabim dhe nuk e bej.Nesje.Eshte e vertete,une krijova nje incident pak a shume publik,qe,meqe me pyete,duhesh ta dish cfare ishte.Ai beri sherr,Pastaj nuk folem me.Une pothuaj nuk shkoja ne pune.Vetem dobesohesha,aq sa,kur erdha ne pune serish,nuk njihesha.Ato kohe i kaloja ose ne banjen e shtepise duke fshire pasqyren nga avujt e loteve,ose ulur mbi tavolinën e punes duke pare nga dritarja gjithë makinat qe kalonin.Derisa nje dite ndaloi makina e tij.Me kerkoi falje.

-Dhe ti e fale?D.m.th.ti e toleron,edhe pse te fyen rende.Pse valle kjo tolerance?Vetem pse ai te do?

- Jo vetëm sepse unë e doja. Të duash, për mua do të thotë të duash pa kushte, të duash edhe kur tjetri nuk te do; të duash, për mua është të mbyllesh sytë, sepse, po i hape, i pe të gjitha, dhe kjo nuk është ndjenjë, është arsyetim, qe vetëm me ndjenjen nuk ka lidhje. Lere pastaj fjala "falje" nuk hyn fare këtu! Unë nuk e takova; gjatë atyre ditëve ndieja ankth nëpër zyre, nuk isha mirë. Sa here me kapte një ankth i tillë, e disa se ai kishte shkuar ne shtepine qe kishte ne fshat, por ato kohe e dija se e kishte shitur. Derisa me ra celulari. "Ku je, o njeri?!" - " Jam ne spital. Jam shtruar, jam keq. Jam si "Paula" jote tani. Po doja ta thosha. Dua qe të dish se tani qe ti nuk je me mua, as ne nuk dua te jem me veten. Dua qe ta dish." Kaq tha dhe e mbylli. Permendi "Paulen", librin e Izabele Alendes, qe unë ia kisha treguar faqe për faqe një mbrëmje ne Dhermi dhe ai me pas më tha se atë nate kishte rënë ne dashuri me mua, atë çast kur tregojta sikur ta kisha jetuar komen e Paulës. Nuk me genjente, duhej te ishte vërtetë sëmure. Nuk kishte pse ta shpikte. Por nuk më tha ne cilin spital. Celulari i tij ishte i mbyllur. Nuk di te ta them saktësisht çfarë bëra atë nate, por e gjeta spitalin. E gjeta dhomen. Ishin te dy. Gruaja flinte ne shtratin përballë. Dhe ai i kishte sytë mbyllur. Unë ndalova vetëm një çast. Një çast te shkurter. Shumë. Kohe me pas më tha se ai çast



e kishte mbajtur ne jetë, ndërsa temperatura nuk i zbriste dhe mjeket nuk ia zbulonin dot virusin. "Ne fillim ndjeva parfumin, - më tha, - pastaj hapa sytë dhe te pashë qe qaje. Pra, me doje akoma. Dhe unë te doja shumë." M'i tregoi të gjitha ne një dhome hoteli një ditë pasi kishte dalë nga spitali. Atë ditë, kur unë ngashereja qe e shtrengoja sërish, ndërsa ai me pushte balluket e lagura.

Dhe nuk e lashe dot. Nuk e lashe mes lotesh, as ne Shen Valentinet e pafestuar, as ne Vitet e Rinj te telefonave frikacake, as, as... E lashe pak nga pak. Perdite e nga një cike.

- Cila qe arsyeja e ktheses sate te vonuar?

- U tremba. Nuk me mjaftonte me familja iluzive. Por pikën e fundit ne kupe e hodhi sëmundja e se shoqes. Ajo u semur krejt papritur nga diçka e keqe. Ndoshta ajo e genjeu atë, ndoshta ai mua, ndoshta ajo shkonte ne palester dhe u tret aq papritur, por mua me kapi ngerci i vdekjes. Sikur ajo te vdiste për fajin tim? Do ta bëja realitet familjen qe kerkoja, por me hijen e një vdekjeje mbi mbulesen e bukes, mbi carcafet e dhomes se gjumit, mbi librat dhe ushqimet. Do te ishim prapë tre ne një shtepi. Nuk ia thashë, por ndërsa ai nisi t'i perkushtohet me tepër familjes se lënë shumë kohe pas dote, unë i largohesha ngadalë, ngadalë.

- Nuk te duket se u përdore prej tij? Ti e doje. E tolerove për moshen, tipin, mungesen e veprimit dhe te burrerise për t'ia thënë familjes ndjenjen qe kishte dhe jetën qe donte te ndertonte me ty. Po ai c'bëri për ty?

- Ma kanë thënë gjithë miqte e mi këtë, me mirë te them ish-miqte, pasi nisa te pertoja t'i frekuentoja, ngaqë ma perseritnin shpesh padobine e kësaj lidhjeje. Do te doja të mos ishte kështu.

- Po planet e tij për te ndjenjur bashke sa reale te dukeshin dhe kur nise t'i shihje me dyshim?

- Të jem e sinqertë, unë ende mendoj se ai donte te ndertonim një jetë te perbashket. Por ndoshta kështu ndodh ne gjithë marrëdhëniet me burra te martuar. Nuk e di, nuk kam pasur pervoja te ngjashme dhe nuk para kam pyetur. Me janë dukur vulgare femrat qe frekuentonin një burrë qe kishte grua. Me krijonin bezdi, kur e hapnin gojen vetëm për t'u ankuar. I mbaja larg. Vetja me dukej ndryshe. Edhe pse unë kam qenë njera prej tyre.

- Po ai kush ishte, njeri prej tyre?

- Me dukej vetja një mundësi e dytë për te. Një jetë e dytë. Kur nisi te bënte plane si do të ndahej, mbaj mend se as e sforcoja, as e nxitja. I kërkova vetëm t'i bënte gjërat sepse donte dhe jo se duhej. Madje, më kujtohet se një nate erdhi në shtepine time për te me thënë se kishte ikur pergjithnje , se do të jetonim bashke, se do të ndahej. Piu dhe fjeti. Ndërsa e kishte zënë gjumi, e kundroja të kishte marrë pjesen me te madhe te shtratit, te carcafeve, te jastekut. U çova me gjunje dhe me kapi një plogeshti e pashpjegueshme. Doja te zgjoja, ta pyesja, te flisnim se ç'do të bëhej me ne, si do të ndahej, ku do të jetonim, kush do të gatuante, kush do të bënte pazarin, a do të merzitej ai kur unë te vija pa humor ne shtepi, a do të nxehej nëse mbaja ndezur abazhurin e dhomes për një kohe te

gjatë, a do të...

Kisha një mijë e një pyetje për njeriun aq afër meje, qe flinte, dhe nuk dija ne po enderronte për mua apo për shtratin bosh ne shtepine qe kishte lënë. Por gjërat rrodhen keq te nesërmen, te pasnesermen edhe me keq. Dhe ja ku jam. Por nuk jam penduar qe u ndamë.

- Qe u ndate? Duhej te ishe penduar qe e nise dhe e vazhdove aq gjatë, aq pafund, aq pa te ardhme marredhenien me te.

- Ndoshta. Por c'vlerë ka te pendohesh? Rendësi ka te vazhdosh. Unë nuk vazhdova dot. U gjenda kaq e paineresuar kur iu ktheva përsëri botës rreth meje.

- Po ai çfarë thotë tani për te shkuaren, te tashmen, të ardhmën e marredhenies suaj?

- Ne kemi mbetur pranë edhe pas ndarjes. Edhe pse jemi takuar përherë e me rrallë.

- E zëmë se ka mbaruar për te dy. Për çfarë te vjen keq nga kjo histori? Për çfarë e fajeson veten?

- Të jem e sinqertë, shpesh pyes veten: "Mos do të ishte me mirë qe këta katër vjet t'i kisha jetuar me katër njerëz te ndryshëm, te kisha pasur katër njohje, katër prova, katër pervoja, pra te isha njera prej atyre qe kalojne nga një marredhenie ne një tjetër pe e vrarë mendjen para gjumit e ne gjume, në vend te harxhoja aq vjet, aq endrra, aq ankthe për te krijuar një marredhenie normale?"

Dhe ne të gjitha rastet do të zgjidhja atë qe zgjodha. Nuk e fajsoj shumë veten. Kështu ndjeva, kështu bëra. Gabova? Zoti me ndjefte! Besoj se gjeja e dytë qe do t'i mesoj vajzes sime pasi t'i mekoj bindjen se dashuria vlen, është të mos e çoje kurrë dem. Unë e provova. E dërgova dem ne një marredhenie prej rere. M'u rrezua para syve.

- Po me thua se tashmë ka mbaruar gjithçka mesh jush, madje as nuk takoheni. Si mundesh ta besosh edhe vete këtë qe thua, kur akoma e tregon me ngjyra ish-lidhjen tënde?

Ti e do akoma.

- A ke dashur ndonjëherë?

- Po, ndaj dhe nuk kuptoj si mundesh ti të mos e duash me.

- Nuk di ne do të ishe kaq i prerë ne përgjigje, nëse unë për gjashtë ore do të te pyesja siç bën ti. Jo, i dashur, unë e kam dashur njeriun i cili duhet ta këtë kapur lemza tani. E kam dashur rastesisht, pastaj gabimisht, pastaj seriozisht. Por nuk e dua me. Edhe dashuria e ka një fund.

- Jo, një dashuri nuk ka fund, ka rrethana qe te detyrojne të besosh se ka marrë fund.

- Si të duash ti. Por dashuria jote e pati një fund, imja gjithashtu, e çdo çifti po se po. Arsyet pse dy njerëz qendrojne gjithmonë bashke, janë përtej dashurisë për te cilën po flasim, dhe unë nuk i njoh akoma.

- Si e kupton ti se do apo nuk do me, as unë nuk di ta kuptoj. Ma shpjego, te lutem.

- Po, por mos më thuaj pastaj se jam bërë zyre folklori, siç e ke zakon, kur shpik ndonjë krahasim. Ndjenja se je ne dashuri me dike është si

ndjenja qe te fal një veshje. Një rrobe elegante te bën te percjellesh klas, seksualitet, sharme, miresjellje, te be te ndihesh e bukur, e dëshiruar. Një pale xhinse e një bluze e gjerë sipër te bëjnë te ndihesh sportive, por te veshura ne një feste te bëjnë te ndihesh keq, mandej pavemendja e te tjerëve te bën agresive dhe te paedukate. Kështu ndodh dhe me njeriun qe do. Kur ti e do, ai gjithashtu, ti e ndien se cliron frymemarrje pozitive, je krijuese, cliron energji te mirë, percjell me te bukuren e vetes, je një grua e bukur. Po nëse marredhenia juaj ka marrë fund, është si të jesh me xhinse ne feste, ti e ndien mosvemendjen e tij dhe e provokon, e nxit, e sulmon dhe mezi pret te te përgjigjet ne te njëjtën mënyrë. Ti do të zihesh dhe percjell energji te keqe, a thua se je ne prag menstruacionesh. Më fal për gjuhën tejet femerore qe po perdor, por unë kështu di ta shpjegoj ndryshimin midis të jesh dhe të mos jesh i dashuruar.

- Do te doja te ishim bashke tani.

- Mos e dergove gabim këtë sms?

- Jo, ta dërgova ty, te vetmit njeri ne botë qe do të doja ta kisha pranë ne këto çaste për t' thënë sa e dua, sa me pëlqen, sa me magjeps, sa me bën te ndihem mirë dhe i mirë.

- Nëse do, mund ta prishesh betimin tënd dhe te me takosh. Tani.

- Jo, do të përpiqem ta mbledh veten dhe te pres ditet e netet qe na perkasin. Nesër do të nisem për Greqi për pune. Nëse do, to marrë ne telefon nga celulari im i vërtetë qe andej, do të mësosh shumë gjëra. Se ka ardhur koha t'i mesosh. Natën, shpirt! Natën!

- Mos na ler te presim me! Natën!

\*18.01.2003

\*Ora 06:30

I panjohuri- Miremengjes! Unë po pi kafen ne kufi. Të uroj ditë te mbarë!  
Unë- Miremengjes! Si ia bën qe udheton, kur fjetem aq vonë mbrëmë? Je me makine? Ti e nget?

- Jam me ortakun. E nget ai makinën. Mos u bëj fare merak.

- OK, por gjithsesi më thuaj kur të arrish. Të shkoftë mbarë rruga dhe puna qe do të besh!

\*18.01.2003

\*Ora 13:30

Unë- Bie shi andej? Këtu me gjyma. Ti shkon ne Athine, apo me afër?

Heshtje

- Arrite? Mirë je? Me shkruaj kur të kesh mundësi, qoftë edhe për t'u pershendetur.

\*19.01.2003

Unë- Uroj të kesh arsye pozitive qe ende nuk me ke shkruar asnjë rresht.  
Unë jam e mërziur dhe e shqetësuar, por s'ka rëndësi. Kalofsh mirë dhe mirardhsh!

\*20.01.2003

I panjohuri- Si je?

Unë- Mirë, falemnderit!

- Përgjigje fare shkurt dhe ftohte. Je e zënë?

- Jo siç mendon ti.

- Nga unë ka diell. Nga ti vazhdon shiu?

- Po me detyron te te përgjigjem, meqë po e kalon me ironi. Unë kam qenë ne merak për njeriun me te cilin fola deri me pesë te mengjesit. Të prita te me shkruaje nga cilido celular, siç premtove, dhe nuk e bërë. Sot kujtohesh te me thuash se nga ti ka diell. E po unë jam e mërziur dhe s'kam pse ta fsheh!

- Kur të vij, do të te them pse nuk të shkrova. Derisa të vij, do të vazhdoj te të mos shkruaj. Kuptome! Ose perpiqu te paktën.

21, 22, 23, 24, 25.01.2003

HESHTJE

26.01.2003

I panjohuri-Miremengjesi!Mbreme jam kthyer.E ndiej qe je zemeruar me mua.Kr te ta them arsyen,nuk do te me mbash inat.Me hskruaj dicka per vete,si ke kaluar?

-Une-Keq,e e inatosur,ne pritje.Po ti?

-Pune.Isha edhe e Itali.Kerkova si ne Greqi,ashtu dhe ne Itali dicka simbolike per ty,por u stepa nga mendimi sei ke pasur prej ish-te dashurit tend.

-Me vjen mire nga mendimi.Stepja edhe pjese e karakterit tend,nuk ta ndryshoj dot.

-Ah,do te me fyesh tani?!Edhe ti ke pjese te karakterit ta nenvleresosh tjetrin.

-Me fal nese e more per keq.

-Sa here do te me kerkosh e do te me duhet te te fal?Nese nuk me thua si ia ke kaluar,do te nis vete te hamendesoj dhe kjo nuk i ben mire komunikimit tone.

-E po mire,qe prej se shtunes ne mengjes qe ti ike e deri kete te hene kam lexuar tre libra te dobet,kam qene ne pune perdite,kam pire kafe koti,kam ngrene aq sa per te shtuar nje kile dhe kam fjetur keq.Kaq.

-Me kerkoi qendra te nisesha per ne Itali,kur po behesha gatite vija ne Tirane.Kisha shume takime pune.Me kerkuan te punoja ne Angli,por jam i paqarte,jo per punen sesa per veten.Ortakui im e vlereson oferten e punes,por mua ne keto caste me intereson me shume ti.

Jam i paqarte per shume gjera.

-Une sa me shume.Po i degjoj per here te pare fjalet:qender,takime pune ne Itali,vendim per ne Angli.Nuk di te te ndihmoj ne kete drejtim.Jam krejt jashte marredhenies sate te punes.Do te ishte ndryshe,nese une te kerkoja mendim.Ti di shume per mua,keshtu qe nuk c'te them,madje as nuk kuptoj pse po m pyet.

-Je shume e dyzuar ne pergjigje.Nuk po te kuptoj.Je vetem pao e shoqeruar tani?

-Jam vetem dhe po pres te me japesh ndonje arsye per te junes se pse heshte kaq gjate.Ndoshta e kam gabim qe kerkoj e kushtoj vemendje edhe kur kam e ke pune.

-Qe ne fillim verejta se nuk sihe ne dite te mire sot.Paskan ndodhur me te vertete gjera serioze pas largimit tim.Mbetet te vendosesh:ose te komunikosh si me pare,ose ta nderpresim.Derisa ti te zgjedhesh,po te jap mundesi vendimi duke pritur ne heshtje reagimin tend.

-Dua te komunikoj me ty si me pare.Dua t jete serish e premte mbrema.Por kjo nuk varet vetem nga une.Pse kerkon te mi lesh te gjthia fajet mua? Heshtje...

-Nese mendon se ka ndodhur dicka kete jave,e ke gabim.Jam ne piken ku u ndame.E deshiruar te te njoh.Ne pritje qe te marresh nje vendim. Heshtje...

-Druaj se po zgjedh nje mbyllje elegante per marredhenien tond.Qendra,Anglia,une jam ne dite jo te mire,pret vendimin tim.Nuk kuptoj.Jam teresisht e corientuar.

-Te sugjeroj te rilexosh sms-te qe me ke derguar sot dhe do te me japesh te drejte pse eshte me mire ta shtyejme komunikimin tone per neser.

-Jo,te lutem mjaftoi nje jave heshtje.Tani qe je ketu,mund te mos vazhdojme te keqkuptohemi me sms,mjaftoi keqkuptimi dhe inati im per heshtjen.

-jo,mendoj se edhe me mire per te dy te shkruhem neser.Nderkaq te bie inati.Ciao!

27.01.2003

I panjohuri-Miremengjesi!Si je sot,me apo pa inat?

-Une me humor.Ti i lire per mua?

-Do te jem ne oren 18:30.Do te mbyll sa pune dhe do te kthehem ne shtepi per te te shkruar.

\*27.01.2003

\*Ora 18:30

I panjohuri- Unë jam gati. Fillojme? Po ta le radhen ty. Çfarë ke ndonjë kërkesë, apo pretendim të ri për mua në lidhje me javen që shkoi?

Unë- Jo, me pare dua te vendosim një kod komunikimi. Nuk dua te këtë keqkuptime. Nuk dua te ikesh i nxehur nga sms-te, as te merzitesh. Dua te jemi e hapur dhe te qete.

- Dakord për kodin. Nëse nuk prish pune, ndoshta kerkoj një nderprerje nga ora 21:00 deri ne orën 22:00, pasi pres një faks nga jashtë.

- Nuk ka problem. Atëherë, mund të nis të te pyes?
- Pa ngurrim. Pyet çfarë të duash.
- Ti ishe jashtë, i zënë me pune. Mendon se unë nuk kisha fare të drejtë të merzitesha pse nuk shkruaje?
- Jo, kishe shumë të drejtë. Po aq sa edhe unë. Nëse do të ishe vendin time, edhe ti kështu do të veproje. Unë te dhashe një sinjal orientues dhe ti duhej të duroje, jo te gjykoje.
- Po të me kishe thënë këtë që dhe, do t'i permbaja emocinet negative. Tani më thuaj me shumë.
- Ortaku im, kur i tregova sa kishin avancuar marrëdhëniet tona, me keshilloi të mos e bëja. Por nuk doja të te shqetesoja duke ta thënë. Dhe tani nuk dua të te them me shumë. Nuk kam të drejtë të te shqetësoj. Por gjithçka kishte lidhje me ty, me ne.
- Mund ta di c'ndikim ka ai në komunikimin tonë me sms? Me njeh ai mua? Çfarë di?
- Kur vendosa të të flas nga celulari im, i thashë diçka. Reagoi kur kujtoi se ishte diçka sipërfaqesore dhe me foli gjatë kur i thashë se ishte serioze.
- Mund të jesh me i qartë. Tashme e nise.
- Në Itali ishim jo për pune, por për të me bindur mua. Ke qenë ti në Itali? Nëse nuk do, mund të mos përgjigjesh.
- Kam qenë, shumë here.
- E kam fjalën me atë, ish-mikun tënd?
- Kam qenë, por nuk besoj të kem lënë gjurmë, sa t'i kesh gjetur ti pas një viti.
- Nuk po bëj shaka. Ndiheh keq kur miqte e tu tregojnë, flasin, dinë.
- Më fal që te pyes, këta miqte e tu mos i kanë të dashurat apo gratë të virgjera?
- Nuk e di, por ndoshta jo të perfolura.
- Ah, po, vërtetë! I njoh marrëdhëniet në fjale. I njoh murgeshat që konvertohen në putana pas dasmes dhe burrat me brire, jo në kërkim të se vërtetës, por të mikeshave për të mbytur inatin. Por flasim për vete me mirë. Po, mund të vazhdosh të pyesesh.
- Jo, me pyet ti me mirë.
- Atëherë, Anglia është reale apo pretekst?
- Reale për nga mundësia e ofertës, joreale si vendim imi. Por tani me fal, pasi më duhet të te kërkoj ndërprerjen e paralajmëruar. Nëse ke pyetje të tjera, bëji gat; nëse jo, do të jem unë ai që do të te pyes kur të kthehem.
- Jo, nuk kam pyetje të tjera. Jam gati të përgjigjem, kur ti të vish përsëri.

\*27.01.2003

\*Ora 22:06

I panjohuri- Më fal, sapo mbarova punë. E sigurt, nuk do të me pyesesh me? Unë - Po, në fakt. Nga 1 deri 10, sa të tërheq dhe sa të largoj unë?

- Ta kam shfaqur se ke arritur here pas here edhe 10, por kjo është shoqëruar me lekundje te forta.
- Italia është një kthim pas për takimin tonë, nëse ti ishe gati ta ofrojë?
- Po. Madje, më duhet ta mbaj te fshehte vazhdimin e lidhjes sone nga ortaku , qe është edhe miku im, për sa kohe nuk kam kunderargumente. Doli siç tha ai: ti ke qenë ne Itali. Nejse. Do te doja te kundërshtoja, t'i faktoja se nuk janë te vërteta ato qe thotë në lidhje me ty dhe ish- te dashurin tënd. Por nuk kam se si. Thelbi është ky: edhe nëse jeni ndare, keni qenë te lidhur bashke, sa nuk është e lehtë te krijosh lidhje me ty.
- Ti je person publik?
- Biznesi preferon te mbetet anonim. Ne Angli ka filluar te eksportohet kapitali, se e shikon c'po ndodh këtu.
- Ndërsa unë jam ne njëfarë mënyrë. Dhe problem duhet te jetë për mua, jo për ty, marrëdhënia jonë publike e mundeshme. Çdo dështim e pesoj unë me duket.
- Po, ke te drejtë. Unë nuk e kisha fjalën te problemet qe krijon publiciteti për mua, por tek ato qe krijoi për ty publiciteti i tepruar dhe negativ.
- Pse, ngaqë rashe ne sy te ortakut tënd? Bëjmë një pakt? Unë mendoj qe ti të flasësh me veten këto ditë dhe jo me ortakun. Ai nuk ka pse te këtë aksione edhe nesms-te tona, mjafton e tepron biznesi juaj i perbashket. Unë kam marrë vendimin tim. Merre dhe ti tëndin, por vetëm. Dhe ma bëj te qartë këtë te diel.
- Dakord ne njëfarë mënyrë. Edhe kështu nuk vazhdohet. E provojme, mbase na çon te zgjidhja. Por mos më lere te jem ne ndikimin e te tjerëve. Thuame ti c'duhet te di.
- Ka dy mënyra: te njohësh ose të duash dike. Ti ke zgjedhur te me njohësh. Unë u perpoqa te te ndihmoja, por nuk mundem me. Më duhet te pres te dielen për te mësuar ç'do të besh dhe për te te treguar ç'do të bëj. Do te doja ta vendosnim bashke, por me duket se nuk funksionon.
- Dallova nota nervozizmi tek ti. Nejse. Atëherë, siç e lame. Të dielen. Drejt finales. Natën e mirë!
- Natën e mirë!

\*28.01.2003

Unë- E di qe e ke mbyllur celularin, por doja te te thosha se me kishte marrë malli dhe më vjen keq qe nuk dita te ta shpjegoja e as ti nuk me kuptove. Ndoshta nuk bëtë mirë qe vendosem ta presim te dielen ne heshtje. Them se gjërat nuk zgjidhen kur u largohesh, po kur u rri mbi kokë. Po e bën dhe ti si unë, qe, kur kam frikë te marr një vendim, nuk cohem nga shtrati, por mbuloj koken me jastek ne pritje qe zgjidhja të vijë vete. Kështu më merr gjumi e shumë -shumë ndonjë ëndërr te keqe shoh.

29, 30, 31, 01.02.2003

HESHTJE

\*02.02.2003

Unë- Përshëndetje! Kur do të shkruhem?

I panjohuri- Menjehere. Së pari, më thuaj ti vendimin tënd, qe me duket se e more atë nate, pastaj te them unë timin.

- Mirë, por nuk dua te merzitesh, as te fyhesh e te heshtësh. Atëherë unë do të mendoj se komunikimi i metejshem me sms është bërë i vështirë, madje i pamundur. Për të gjitha arsyet qe ti tashmë i di. Unë e kam bërë zgjedhjen time: te te takoj ty, te te njoh ty, te hyj ne fazen e dytë te marrëdhënies me një njeri qe me tërheq shumë. Të përket ty te me thuash ç'do të besh.

- E pse duhej te fyhesha prej vendimit tënd?

- Ndoshta jo aq prej vendimit sesa prej pasojave. Druaj se do të tërhiqem, nëse ti vazhdon te me bindesh se duhet te komunikojme ende me sms. Ndaj t'u luta të mos merzitesh e te të mos duket sikur te ve kushte. Dua të flasim dhe te vendosim tok.

- Mendon se unë si maskull nuk kam dëshirë te te takoj sa me pare? Se nuk dua unë te te kem time? Se dua te shpik teknika të reja dashurie me sms? Mendon se unë nuk dua te jem, nëse e meritoj, i dashuri dhe burri yt? Jam dakord qe sot duhet ta mbyllim komunikimin me sms. Të marrim pjesë te dy për t'i thënë të gjitha dhe t'i japim fund, për mirë, shpresoj.

- Aq me mirë, atëherë.

- Unë e nisa komunikimin drejtperdrejte, se besova te sinqeriteti yt, edhe pse me detyrove te pyes te tjerë.

- Jo, mendoj se ti nuk ishe i gatshëm te me besoje. Dhe me te drejtë. Nuk me shikoje ne sy kur shkruaja. Unë nuk dua qe ti te pyesje te tjerë. Dhe kisha te drejtë. Ti u merzite, unë u fyeva.

- Unë kam seleksionuar gjithçka mesova nga te tjerë dhe te kam ruajtur ne maksimum qe të mos ndihesh e fyer. Aq sa te kem thënë, besoj se i ke pranuar si te vërteta?

- Nejse, do të flasim ende për çfarë thonë te tjerët, apo do t'ia dalim bashke? Do te vendosim te dy për te dy?

- Nuk dua te debatojmë kur te takohemi. Dua t'i kei lënë pas të gjitha dhe për këtë t'i detyrohemi komunikimit me sms. Thame qe i sotmi do të jetë i fundit. Dua te ndaloj dhe pak te rruget e tua jashtë. Më fal, por më duhet te jem i qartë. Ke qenë disa here ne Itali, Greqi, Maqedoni, Mal te Zi. Pse nuk m'i ke thënë?

- Unë kam qenë ne një pjesë te mirë te botës për pune.

Ne disa prej vendeve qe rreshton ti, edhe me te. Por nuk me ke pyetur për udhëtimet e mia. Dhe ne thelb është e parendesishme. Të jesh ne shtratin e shtëpise sate apo te një hoteli të huaj, nuk ka asnjë ndryshim me duket.

- Ka, madje shumë, sepse tregon një lidhje te konsoliduar.

- Jo, një lidhje normale ka edhe rrugë qe bëhen jo për dashurinë e madhe qe ndien njeri për tjetrin, por se nevoja për te levizur duhet ndare me dike. Mos u ngatërro, te lutem.



- A ke qenë ti e singertë me mua kur ke thënë se çdo gjë me te është e kapercyer, e mbyllur?
- Dyshon akoma? Ta kam thënë: te takoj apo jo, unë me atë nuk kam me marrëdhënie. Nuk na ndave ti. As nuk do të bashkohem nëse ti nuk me takon. Unë me ty jam treguar vetëm e singertë, me gjithë friken prej anonimatit tënd.
- Po sikur nesër ai te lirohet nga gruaja? Unë nuk e kam kuptuar, me sa di për ta, pse e durojne ende njëri-tjetrin. Ç'do të besh ti atëherë?
- Dhe unë nuk e kam kuptuar, te jem e singertë. Mbase thelle-thelle ata duhen. Por unë nuk vij e iki me urdher te peshkut. Hajde ti, se iku ajo! Futja kot tani!
- Po kur ai ta marrë vesh se isha unë- njeriu qe e njeh- ai i sms-ve? Kur te mesoje se çka diçka serioze mes nesh, çfarë do të beje?
- Do te na vrase, ç'do të beje tjetër?! Nuk te duket e tepert te te përgjigjem singërisht edhe për te? Por them se ai do të vazhdoje jetën e tij. Do te martoje vajzat, do të bëhet gjysh, do ta shtyje me gruan; ne mos e shtyfte, do ta lere. Por them se nuk ka dallim nëse ti e njeh apo jo. Nëse na duhet te mendojmë për dike, duhet te jetë vetja, jo bota.
- S'besoj se për ty ai është bërë kaq shpejte "bota"!
- Sipas pervojes sime modeste, njeriu ka ca çaste kur do ta kujtoje te kaluaren dhe te rikthehet me shpirt e mendje tek ajo. Por ato janë vetëm ca çaste. Pjesa me e madhe e vërtetë është perpjekja për te qenë i lumtur. Dhe te tillë te bëjnë kujtimet. Unë hyj te njerëzitë qe përpiqen jo t'i kalojnë ditet duke qare, por duke vazhduar përpara, për vete e ke kanë ne zemër. E për zemër kam ke dua e mbaj ne krah.
- Më fal, por pyetja e frika ime nuk kishin te bënin me ty, por me qëndrimin e tij, me te drejtën qe ai i jep vetes në lidhje me jetën tënde.
- Po pse mendon se ai mund te këtë ndikim mbi jetën dhe vendimet e mia? Kaq budallaqe te dukem, sa te lejoj te ma prishe e ndreqe jetën e kaluara?! Unë jam e ndjeshme, por jo e dobët. Llogarite vete diferencen. Nuk e kuptoj fare friken tënde. Pse e mbivlereson dhe pse mendon se do të reagonte nëse unë do të kisha një lidhje me ty. Mbase nuk do të ishte i lumtur, mbase, nëse te njeh te vlerëson, thelle-thelle do ndihej keq për vete dhe mirë për mua. Ku i dihet?
- Po sikur dashuria e tij për ty të mos jetë një e kaluar, por një e ardhme e pritshme, qe mund te ngacmohet edhe me shumë nga ideja se po të marrin?
- Më fal, por mos vazhdo, te lutem, te me kerkosh përgjigje për pyetje qe i duhen bërë atij. Apo je duke me thënë, fjale te tjera, se do të flasësh me të parë se te me takosh? Beje, nëse te ndihmon! Por te lutem mos na e veshtireso edhe me shumë gjithçka. Mos kërko justifikime, por arsye. Dhe them se arsyeja është me mua.
- Mos harro thelbin e shqetesimit tim. Dua qe, kur te takohemi ti dhe unë, te jemi te lirë te vendosim vete, pa na nderhyre e kaluara, aq më pak protagonistet e saj.
- Them se unë do të jem e lirë për te vendosur vete. Për ty nuk e di. Duhet te te njoh qe te kuptoj me shumë. Ta ndiej thelbin e shqetesimit, por për

mua mos rri ne merak.

- A mendon se ti ose unë duhet ta vëmë ne dijeni me pare për komunikimin tonë me sms deri ne këtë pikë qe ka ardhur?

- Jo, nuk do të me pelqente. Ai nuk është im atë, qe t'i kerkoj këshilla. Pastaj, unë s'jam prone, e ai s'është pronari. Do te me dukej dobesi nga ana jote dhe falsitet nga ana ime. Por ti bëj si të duash. Unë për vete nuk e bëj.

- Qarte. Ti e ndien veten, pra, teresisht te pavarur nga marrredhenia e djeshme dhe e sotme, si mik me te. Nuk ke nevojë as për keshillime.

- Po.

- Pra, mbetet te veproj unë. Me duhen ca ditë para se te vendoj përfundimisht.

- Çfarë dyshimesh mban ende? Mund te me thuash, ndoshta jo me hollesi, ç'ke nder mend kur thua se do të veprosh?

- Mendoj se nuk kam te drejtë te te merzis me ngurrimet e mia, te cilat duhet t'i qartesoj vete brenda disa ditëve. Do te jetë komunikimi i fundit me sms mes nesh, besoj.

- Si të duash. Mendova se komunikimi i fundit ishte sonte, kur dhe do t'i sqaronim bashke të gjitha. Vendimin tënd, për mirë a keq, kur do të ma besh te ditur?

- E shumta te merkuren ne darke. Më duhet të mos e zgjas sonte, pasi pashë mungese dëshirë tek ti për te diskutuar çfarë nisem.

- Nuk me mungon dëshira, mund edhe ta nisim nga e para, po të duash, por nuk me pëlqen qe na duhet të flasim vetëm për te, aq sa here-here me krijohet pershtypja se ti interesohesh për te dhe jo për mua. Me duket se ta kam thënë edhe tjetër here këtë.

- Me vjen keq qe gjithnjë e ke marrë se flasim për te. Nuk më ka interesuar asnjëherë ai, por ajo pjesë e jotja e lidhur me te.

Gjithsesi, me mirë e mbyllim sonte, presim te merkuren.

- Do te doja ta dije se kam dëshirë te me takosh te merkuren, jo thjeshtë ngase jam kureshtare - dhe jam shumë - por sepse ti je i mirë, je i mencur, je i permbajtur dhe mua me shijoi komunikimi me ty. Do te doja ta dije këtë.

- Falemnderit për fjalët e mira! Unë te miat t'i kam shprehur me kohe. Dhe te siguroj se mbetesh shumë e mirë për mua, kaq e mirë, sa nuk gjej fjale te ta them. Të uth fort. Natën e mirë!

- Edhe unë. Uroj qe këto tri ditë të mos takosh njerëz qe te te ngaterrojnë. Jo gjithmonë e bëjnë për miqesi. Them unë te paktën. Natën!

- Nuk doja t't drejtohesha te tjerëve, ndaj nisa këtë komunikim kaq te çuditshëm e te paprovuar me pare. Por mëso se di ta mbroje atë qe dua dhe nuk flas me cilindo.

- Atëherë, nëse di te me mbrosh, edhe pse s'di te kem bërë ndonjë faj, me fal qe ta them, pse pret te merkuren? Me tako nesër.

- E thame: te merkuren. Natën e mirë për sonte!

- Natën! Kush pret deri te merkuren? Ne mos qoftë e diel prapë! Më fal, me fal! Natën!

- Natën! Natën!

\*05.02.2003

Unë- Sot ne mbrëmje do të shkruhem? Të kujtohet, apo jo, qe sot është e mërkurë?

I panjohuri- Sms-te e tua nuk mund ti marr si nevojë komunikimi. Qartazi ato vazhdon t'i ndash me te. Nuk ke qenë e sinqertë me mua. Nuk funksionoi për shkakun tënd. Pasi shumë gjëra qe ti nuk m'i the, mesova nga miqte. Me te nuk komunikova për te respektuar kerkesen tënde. Edhe kjo sihte domethenese për mua. Por respektoj edhe paktin për të mos vazhduar me komunikimin me sms. Nëse do të vendosesh te ndrysoh, numrin e celularit e di tashmë.

- Ti po me tremb dhe më vjen keq qe nuk do të këtë me te neserme për te sqaruar keqkuptimin e radhes. Nuk te kerkoj te me shpjegosh vendimin tënd. E kam te qartë tashmë. Vetëm më trego çfarë te ndodhi.

- Vete me komunikove vendimin tënd: mjaft me sms. Të siguroj se jam ndikuar nga e vërteta dhe nuk ka keqkuptime. Pa pasur ciltersine tënde, nuk mund te hidhja asnjë hap. Ne sms-ne qe te nisa pak me pare, megjithatë te lashe edhe një mundësi.

- Çfarë mundesie me ke lënë, se nuk arrita ta kapja? Sot prisja orën e takimit.

- Kur të jesh me e qete, rilexoji sms-te e sotme qe ta kuptosh. Nëse do të takohemi.

- Unë edhe tani jam shumë e qete dhe e bindur se dua te takohemi. Po të pyes ty: je i sigurt se nuk e do me këtë? Je i bindur? Shumë i bindur?

- Po, pasi, po t'i dija ato qe mesova, nuk duhej ta kisha nisur fare komunikimin. Sms-te e tua tani i kuptoj me mirë. Jam i bindur.

- I bindur për çfarë, qe unë jam?... Me bëj pershkrimin më pak fjale te asaj qe je i bindur se unë jam.

- Mbetesh e mirë për veten dhe për atë tjetrin.

- Falemnderit! Ti mbetesh i mirë, gjithashtu. Ishte një kenaqesi qe komunikua bashke. Një ditë, kur ti të jesh realisht dyzetvjec, siç me ke thënë, eja me tako. Do te më duhet një mik si ti.

- Ashtu?!

- Nuk ta përmenda moshen për te te ngacmuar. Të bëra një thirrje te heshtur për t'u rritur, për te besuar, larg gojeve te bërë për te folur.

- Një ditë do të takohemi. Vendosa ta firmos kontraten. Do te nisem për ne Angli.

- Të vafte mbarë, sinqerisht, kudo qe të shkosh dhe çfarëdo qe te besh!

- Të njëjtat urime dhe për ty. Të vafte vetëm mbarë! Ta uroj me gjithë shpirt, edhe pse jam i fyer.

- Se kush duhet te jetë i fyer, është një teme me vete, qe do të na beje ta nisim nga e para, por me mirë e mbyllim pa sqarime. Janë te panevojshme tashmë.

- E mbyllim, atëherë.

6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13.02.2003  
HESHTJE

\*14.02.2003

Une- Sot nuk munda te rri pa te shkruar perseri. Ne ka ekzistuar ndonjehere ndonje lidhje mes nesh, sot te pakten duhet ta hapesh celularin. Thone se 14 shkurti eshte dita e te dashuruarve. Po ne te dy cfare qeme? Pse u shkruame aq gjate? Pse hesht sot? Kush je ti? Me ndihmo te pakten te heq dyshimin se ti nje person qe ka dashur te me hetoje a te me vere ne loje. Po fol, o njeri! Kujt i shkrova kater muaj? Thuame kush je, pastaj ik, nese do! Kaq nuk meritoj?

Po, mire o i panjohur i paarsyeshem, nuk te bejne pershtypje gjithë keto sms kaq lutese, sa pavetedija jote e ngacemohet tani dhe te te beje te hapesh celularin e te me lexosh, me se paku.

Kam nevojë te hapesh celularin. Ndhme! Kam nevojë te me pergjigjesh sot. Te me thuash kujt ia kushtova kater muaj komunikimi, me ke fola, me ke u rrefeva si me veten.

I panjohuri- Nuk te lodhi kjo histori?

- Ah, e hape celularin?! Eshte nje shenje, sidoqofte.

- Thuame, te lodhi?

- Me semuri, ne do te dish, ne te ben mire ta dish! Por nuk kam hequr dore, dua te di kush je.

- Ngaqe je kureshtare.

- Jo, nuk eshte me kureshtje. Eshte me shume. Te kam qene prane kater muaj te gjate mesazhesh. Sot ti duhet te ma thuash, sot ti do te ma thuash me ke fola!

- Keta kater muaj me kane lenduar mua qe te kerkova sinqerisht te lidheshim. Ti u talle duke u treguar e pasinqerte dhe me ke fyer, a thua se isha nje femije nen dyzetvjec, grua a detektiv. Jam i bindur ne vendimin ti,. Mesova, jo nga ti, por nga te tjeret, se kush je ne te vertete. Vazhdo apo perfundo marrredhenien qe ke. Kureshtja per mua do te kaloje. Pac fat me te!

- U lodha duke t'u lutur te me takosh. Madje, nuk e di nese dua ende tani pas ketyre qe thua. U lodha duke t'u lutur te me besosh. Ti je njeri i ndikueshem, jotolerant, mosbesues. Duhej te isha une e tille. Nuk te njoha kurre. Nuk dita me ke flisja. Nuk di me ke flas, por kam qene shume e vertete me ty. Une kam dashur gjithë jeten dhe dua akoma te gjej njeriun me te cilim te kem komunikim te brendshem. Nuk ka qene e mundur. Kam gabuar ne ato pak zgjedhje qe kam bere. E ku e dine miqte e tu vetmine e marrredhenies sime, cigaret, bulimine, c'mund te thone ata per sa u perpoqa une te ndertoja nje marrredhenie dhe e ndertova, ndonese me balte deti.

Por kjo nuk me ben nje te deshtuar, aq me pak nje kurve, sic u pelqen ndoshta atyre te te thone. Por nuk u ve faj. Ty po. Ti me njohe. Une te lashe te me njihje. Une te futa brenda meje. Une mezi prisja te me

shkruaje. Une te besova, pa ditur asgje per ty. Madje, kurre s'kerkova te mesoja, as duke te pergjuar celularin, as ne ndonje menyre tjeter. Thjesht te lashe te vije vete. Nuk erdhe, por po ta kerkoj edhe nje here, jo per kureshtje, por per detyrim ndaj vetes, per deshire te cmendur, t'i japim edhe nje mundesi lidhjes sone per t'u bere reale. Sot eshte 14 shkurt. Eshte pikerisht dita kur do te doja te te takoja. Te ftoj te me takosh sot. Hame dreken bashke dhe ne darke apo nesor nisu i qete ne Angli. Heshtje.

\*\*\*

Kjo ishte gjithcka doja te te tregoja. Me 14 shkurt mbaruan me te vertete pergjithmone sms-te. Numri i tij ishte thjeshte i padisponueshem per cdo thirrje e mesazh te deshpeluar qe dergoja. Nuk di te ta them se si ndihesha. Pas cdo zhurme qe ben mesazhi kur vjen, brof e tromaksur se mos ishte ai. Dhe ai nuk ishte asnjehere. Nuk u be kurre i gjalle dhe bashke me te humbi te une edhe ajo pak shprese se ne kete bote ndodhin cudira. Me beso: nuk ndodhin kurre. Nuk eshte kurre asnje i panjohur pas dere, qe pret vetem ta shtyje porten, te te shohe ne sy e te te thote se te do. Nuk eshte.

Por per fat, ne te tilla raste, kur te le gjithcka: edhe deshira per te care perpara, edhe endrrat e dreqi me te birin, vetem mendja nuk te le. Sa cudi! Asnjehere nuk e kam kuptuar si funksionon ky mekanizem qe quhet tru dhe eshte ne gjendje te perballoje te gjitha e te gjitha. Te mban kur te leshon zemra, stomaku dhe ti ndien se gjaku po te behet uje. Ku qendron, si te ben te buzeqeshesh kur je ulur ne nje bar ne pritje te asgjese dhe kamarieri te afrohet per te te sjelle fruta nga lokali? Dhe ti falenderon, buzeqesh dhe harrohesh pak duke menduar se jo cdo gje eshte bardhe e zi. Mandej prape kujtohesh c'te ka ngjare, e prape ndihesh e vdekur dhe merr nje taksu e shetit pa adrese me deshiren e vetme qe ajo te perplaset; e kur kjo s'ndodh, sic nuk duhet te ndodhe asnjehere asgje e keqe kur lutesh per te, nis e kerkon nje fije kashte, vetem nje fije ku te kapesh dhe sjell nder mend gjitha emrat e te njohurve a miqve, por nuk ndien asnje deshire per te takuar kend e t'i tregosh. Po c't'u tregosh?!

Ndaj edhe nuk te shkrova me pare, nuk dija cfare doja te te thosha. Isha ne nje pus, ku nuk me kishte shtyre kush, u futa me deshire, mbylla kapakun me deshire dhe po mbytesha me deshire.

Une nuk njoh, per fat ndoshta, asnje fatkeqesi tjeter, pervec atyre qe prodhon ndjenja e humbur, qe te te beje a ndiesh humbjen deri ne palce. Pa dyshim qe duhet te kete te tjera, por te thashe: kam pasur fat e nuk i kam provuar. Dashuria, kjo imja them, ishte pertej, ishte ndermjet, ishte sikur te mos ishte. E dyzuar ndermjet asaj qe provova dhe nuk e preka, e ngaterruar mes krenarise dhe tundimit per ta kerkuar edhe nje here, dhashe ate intervisten qe nuk e kuptoi kush pervec tij. Ti me bere aq shume pyetje atehere, te kujtohet? Por nuk doja, as nuk dija te te ktheja pergjigje. Ja, po ta them tani: e kerkoja te kthehej.

E mban mend c'thashe? "Nuk mendoj se jam e dashuruar ne ate kuptim te mirefillte te fjales qe ka fjala, por kam gjetur ekuilibrin e perkryer te komunikimit me dike. Nje marredhenie jo fizike, jo reale, nepermjet se ciles orvatemi te shkojme drejt dashurise ne menyre vezhguese, njohese. Me mjaftuan kater muaj per te kuptuar se ndoshta deri tani kam pasur ne koke nje renditje mbrapsht te gjerave. Te cdokush gjerat funksionojne ne menyren e vet. Tek une, me sa duket, duhet te funksionojne keshtu: para se te kem nje lidhje reale, komplekse, ndjesore dhe logjike duhet te komunikoj gjate dhe besueshem."

Ne te vertete une e kisha humbur tashme kete "komunikimin e gjate dhe te besueshem", kur intervista doli dhe prita me dite te tera qe ai te behej serish i gjalle me ta lexuar.  
Nuk e beri. Asnjehere!

Ta marresh veten ne dore ashtu isc eshte, copa-copa dhe ta ribesh e ta rikthesh ku ishte apo ku do te doje te ishte, me duket nje perpjekje gjigande, por e bera, sic e ke bere dhe ti kur humbe dashurine tende, sic e kane bere gjithë mikeshat tona te perbashketa. Si ti, ashtu dhe une nuk e bera ne nje dite, po pak nga pak, pa e kuptuar iken ditet e frikshme kur nuk doja te haja dhe erdhen dite kur orizi me fruta deti i "Ambasadorit" me dukejt pjata me e shijshme ne bote. Te kujtohet kur te shkrova nje dite: "Sot henga nje supe te bukur"? Sa kemi qeshur! Po c'te beja? Duhej te bija ne dashuri me supen, me qenin e komshies, qe, kur e qethnin, me dukej si dele: me sandalet e reja, te cilave iu keput rripi nje dite pasi i bleva: me modelin e re te flokeve te prere shkurt, me c'te gjeja e mundesha, vetem te mos ishte njeri. Nje njeri do te ishte i tepert, i paperballueshem per ditet qe, edhe kur vinin, me dukej sikur pi i jetoja per here te dyte.  
Keshtu, beja sikur harroja. Si nuk u shpik nje hape per harresen? Nje hape si ato qe kerkonim kur ishim te vogla, qe ta pinim dhe menjehere te dimen anglisht.  
Keshtu te ishte edhe hapa e harreses, ta pije dhe te harroje ne cast e te te ngjante se e keqja nuk kishte ndodhur kurre.

\*\*\*

Nuk po zgjatem ne cdo minute, dite e muaj qe erdhi me pas, se ne te vertete nuk ndodhi asgje per t'u treguar.  
Hic fare! Por kete e ke marre vesh edhe na e mail-et e meparshme. Me mua nuk ndodhi asgje. Ti asnjehere nuk me ke besuar kur te shkruaja se shkoj ne pune, vij nga puna, shkoj ne shtepi, dal nga shtepia dhe kaq. Te duket sikur te genjej, nuk arrin dot ta besosh se jeta e nje vajze ekrani nuk eshte patjeter me ngjyra si kostumet qe nderron cdo mbremje kur jep lajmet. Sheh shume TV, e dashur, edhe aty ku je e vazhdon te enderrosh, si une dikur, qe enderroja te isha njera pej tyre, me nje model flokesh per t'u imituar. E pastaj? Pastaj ti je vetem nje vajze ekrani dhe kaq. Sa te mjera jemi ne thelb ne! Na duan te gjithë, kur na duan dhe nuk na do askush edhe kur na

do.Ti je vetem,ulesh diku,te buzeqeshin,te shohin,ndryshojne biseden e tavolines ku jane ulur,duke treguar gjithë c'dine e marrin me mend per ty,por asnje nuk te afrohet.Ose dhe po t'u afruan,e shumta per te te qerasur.Ti mbetesh per ta nje vajze ekрани,Edhe te rriturit jane si femijet:kujtojne se ti i perket ekranit dhe se u duhet te thyejne ate,te zgjatin doren brenda televizorit per te te prekur dhe folur.E kush ka kohe te mundohet kaq shume?...

Keshtu qe mjaftohen te thashethemojne per ty.Ah,kete po,e bejne mire!Nese te shohin me shume se dy here me nje femer,ti je lesbike.Nese te shohin perdite ne varreza per te cuar lule,te moren per nekrofile,e c'te te numeroj,e di qe serish nuk do mund te te bind per vetmine qe provon kur je njezetetetevjec.Nxj err koken pernate ne ekran dhe komunikimi yt me boten perdite e me shume behet nepermjet celularit dhe internetit.Dhe ne nje nga ditet qe kaloja symberthyer ne e mail-e,qe nuk kerkojne pergjigje,se jane publicitetprej atyre qe te gjejne adresen ne internet e nuk te ndahen,ndodhi me pak e papritura:telefonoi mamaja ime.Me pyeti ne njihja dike qe studionte ose punonte ne Londer.Ia mbylla celularin pa pergjigje dhe u nisa ne shtepi.Sic ndodh zakonisht ne filma me skenar te frymezuar prej rastesive te keqija,ime më nuk ishte atje,por ne pune.I kishte telefonuar nje zonje se donte ta takonte.Cuditerisht,gruaja quhej Enkelejda,nje emer disi i pershtatshem per nje shtatedhjetevjecare me ze lozonjar ne telefon,sipas nenes sime,por kush i ve re hollesite ne te tilla raste?

Djali isaj i vetem punonte ne Londer dhe to te kthehej ne gusht per pushime ne Shqiperi.Por ajo donte te fliste me mua dhe familjen time para ardhjes se tij.

"Ai e do shume vajzen tende,kete ma ka treguar,por nuk ka dashur te me thote pse s'lidhet me te",-ksihte thene zonja plake,duke i rrefyer mamase sime gjithë imtesite e jetes se saj prej vejushe ne vite,mallim per djalin,qe e kishte lene Tiranen disa muaj te shkuar dhe deshiren per te mos vdekur pa e pare te birin krahe meje,qe isha "si shpirt".

Me kapi nje inat i madh me mamane,qe vetem e kishte degjuar dhe nuk kishe pyetur as per emrin,emrin e atij,qe nuk kisha ma asnje dyshim se ishte ai,njeriu i sms-ve te gjata.Madje,ajo nuk e kishte pyetur as per mbiemrin,qe te nsija te kontrolloja librin e telefonave per te gjetur nje numer,nje gje reale me ne fund.Por hiq!Mamaja nuk ishte marre vesh asgje,duke e ngaterruar telefonaten me nje prej te shumtave qe s'e cuditnin me qysh kur une kisha dale n ekran.Kur me pa mua qe nuk flisja,por bertisja pa ze per te bere te kujtonte dicka me shume,me qetesoi duke me treguar se ajo do te vinte vete ne shtepi,e kishte mesuar adresen dhe do te vinte ne njerren prej atyre diteve me te bijen.

-Paskesh edhe vajze?Domethene ai ka moter!Po motra cila edhe,si quhet?-pyeta une e mekur.

-Ah,po,vazja punonte ne Ministrin e Jashtme,po,po keshtu tha,-vazhdoi mamaja.-Do te vijne bashke ne shtepi te flasin me mua,qe nuk po kuptoj asgje,Do te me thuash ti si eshte puna,qe te mos e mesoj prej tyre.

I tregova se behej fjale per njeriun e sms-ve,per te cilin i kisha folur dhe ajo e kishte marre per fantazine time te radhes.Se mos vetem ajo!Edhe motra ime,qe here pas here lexonte fshehurazi mesazhet dhe shkulej se qeshuri me idene se une neuk e njihja njeriun ti cilit i shkruaja ne shtrat,ne tavoline,edhe ne banje,kur ajo me ndiqte nga pas te me merrte celularin,Tani qe doli se ai ishte i vertete edhe jo shpikja ime,qe ksihte edhe nej mama e nje moter,mamaja dhe motra ime nuk dinin c'te me thoshin,vetem nisen te kujtonin bshke me mua c'i thosha e c'me thoshte dikur.Te tria nisen te bejme plane per ata tre te tjeret,te panjohurit,per te cilet tani kishim vetem nje fjale magjike:Enkelejda,emri i vejushes 70-vjecare me se lozonjar ne telefon.Edhe pse pa mbiemer,nuk m'u durua pa hapur librin e telefonave se mos kushedi gjeja nje numer per emrin ,gje qe rezultoi marrezi.Nuk ecte kerkimi me emer ne numerator.Por nuk u terhoqa,u telefonova gjithe njohurve te mi ne Ministrine e Jashtme per t'i pyetur ne njihnin dike qe punonte aty se ciles ia quanin nenen Enkelejda.Por nuk more dot pergjigje.Atehere iu riktheva mamase duke e pyteur mis kishte harruar dhe ajo i kishte nje dite te sakte apo nje orar se kur do te vinte ne shtepi.Por hiq,asaj nuk i kujtohej te kishin lene dicka te sakte.

Te nesermen,te pasnesermen dhe gjithe javen i telefonoja cdo pese minuta mamase:"He erdhi kush?Po sikur te kete ardhur dhe ti nuk ke qene ne shtepi? Mos dil pasditeve,se me siguri ato pasdite do to vijne." Por nuk erdhi asnjeri,asnje pasdite te asaj jave.

Ne mbremje ra telefoni.Ishte ajo,zonja plake me ze lozonjar.

Foli e mamane.Une nisa te dridhesha,aqsa nuk mbaja dot receptorin ne dhomen nga pergjoja biseden e mamase me te.

Kapa vetem fraza te shkeputura:"Do te vijme neser,para drekes...mire,ora 12:00...une dhe vajza. ...Si eshte vajza jote?...Djalit nuk i kemi thene,por ime bije pyeti dhe me tha se vajza jote ka nje lidhje,cka nuk eshte e vertete,po asaj keshtu i thane,mire..."

E ula receptorin pa ditar ne duhej te gezohesha qe ato do te vinin ne oren 12:00 te dites tjeter apo te friikesohesha,sepse gruaja pak me pare sapo kishte perseritur frazat e fundit qe une kisha shkembyer me te birin ne fillim te shkurtit.Dicka nuk ishte ne rregull,por une kisha vendosur t'i shkoja deri ne fund kesaj historie,duke pritur mengjesin me bindjen sse do te m'i sqaronte te gjitha.

Dola heret,duke iu lutur mamase te kthehej ne shtepi para dymbedhjetes dhe sidomos te mos fliste fare me to per mua mbi te gjitha te mos tregonte se dinte historine e sms-ve.

Nuk me kujtohet si dola nga shtepia,ne flisja me vete ndersa zbrisja shkallet dhe ngjisja ato te punes.Dhe nuk e kma pyetur kurre mamane me pas se cfare beri ajo,cfare mendonte kur merrte pluhurat e tavolines,tavolines se madhe me dru arre,qe e kishte shoqeruar historine e familjes prej '39-s dhe me kishte pare mua kaq here te strukesha te kembet e saj,kur binte shi. Ne oren 12:00 ra zilja.Mami kishte lyer syte,cka ni ndodhte rralle.Iu duken edhe me te lyer kur hapi i hapi forte ndersa me pa mua ne dere.

"Nuk do vijne,ma,nuk do te vije kush",-kete me duket i thashe dhe u ula



bashke me te.Nuk me pyeti e nuk i folat.U ulem si dy te huaja qe takohen ne nje aeroport dhe duan te flasin me njera-tjetren,por nuk munden.I pengon gjuha.M'u duk se e kisha perjetuar edhe nje here ate cast,kur ksiha marre pa dhene puthjen e pare.Edhe atehere i isha ulur prane pa folur.Vetem e rrija ngjitur,ngjitu,sikur doja qe ajo te me shikonte buzet dhe ta kuptonte se e vogla e saj ishte rritur.Ndersa ate dite,kohe e kohe me pas,i rrija prane pa folur,duke u munduar qe ajo ta kuptonte se e rritura e saj ishte e vogel.

\*\*\*

Atë ditë,ndërsa unë rreshtoja minutat e pritjes se madhe,me kishte rënë telefoni.Ishte ai,burri i martuar,qe pikërisht,me kishte atë çaste e kishte zgjedhur krejt gabim,por megjithatë iu perjigja thirrjes.Telefoni për te me thënë...-me ndiq me kujde!-...për te me thënë se...po ta them ngadalë-ngadalë,pasi e di se do të hutohesh e nuk do të me besosh.Se mos unë e besova kur ma tha!

-Mirë je?

-Mirë,po ti?

-Me ke thënë dikur se shkembeje sms me dike?

-Të kam thënë.

-E takove?

-Jo,por,jo,jo.

-Kam ne dorë gjithë komunikimin tënd me te,te gjithin.Ti paske rënë ne dashuri me gruan time!...

-Si the,si the?Si gruan,gruan e kujt,çfarë thua?

-Ku je të vij te te marr?

-Dola,e takova.Me la ne dorë 40 faqe A-4,te shtypura ne kompjuter,te lidhura dhe ne kopertinen e tyre intervista ime,ku bëja publike "komunikimin e gjatë dhe te besueshem".Ne krye te intervistes fotoja ime."Oh,budallaqe,budallaqe,budallaqe e vogël!"-vetëm kaq shqiptova.Me pati vënë ne loje,me pati perdorur,ndjekur,mashtruar për e mësuar te vërtetën e lidhjes sime me te shoqin.Ne mënyrën me te poshtë e te mencur njekohesisht,me naive dhe te sifistikuar.Ngasher eja teksa shfeltoja faqet e sms-ve

te mia katër mujore duke kujtuar.

Pastaj nisi të fliste ai,duke me treguar se këtë nuk e kishte bërë e shoqja.Ajo duhej të kishte ngarkuar dike,qe ai mendonte te ishte një i njohur i familjes,dikur psikolog,tani i papune,ndonëse ajo kembengulte se dikush sapo ia ksihte dërguar ne shtepi.

Por fjalët e tij iknin vrikthi,pa arritur te me ceknin veshin.

Po,ajo kishte marrë hak.Jo ne mënyrën qe prisja unë teksa ngarkoja me vete kërcënimet e saj nga Tirana,ne çdo valixhe qe merrja me vete ne Uashington,Paris a Talin,Jo si ne zgjimet qe me llahtarasin ne Venecia,kur shtratit e ndaja me te shoqin dhe enderrat me te.

Ajo ksihte marrë hak duke me dhënë e marrë një tjetër dashuri.Me dukej sikur me kishte vdekur dikush,dikush i afert,i dashur,dikush si

vetja.Madje,me shumë se vetja,me shumë se shpresa për te takuar atë qe kisha kërkuar te njeriu qe me pershperiste përballë dhe te njeriu i doreshkrimit qe mbaja ne dorë.Me kishte vdekur mundësia për te besuar përsëri se diku,dikur gjendet dikush qe mjafton ta shohësh ne sy,mjafton te të flasë,te te shkruaje ndoshta dhe do ta kuptosh se është ai,ai qe ne bisedat tona te femijerise ishte marinari i abetares ,qe shpetonte ne det një vajzë duke u mbytur te germa "d" si deti,"d" si dashuria.

Qe te dyja ziheshim kush do ta merrte për burrë.Pastaj,ne peshpeshet e parambremjes u e djali me i bukur i shkolles,për te cilin ziheshim.Të kujtohet kur të thashë se atij i pëlqenin vajzat me folke te shkurter,ngaqë kisha zili floekt e tu te gjatë.Dhe ti i preve.

Ndërsa ne takimet tona te shkolles se mesme për mua ishte një djalë qe duhej te lexonte shumë libra,për ty një djalë qe te udhetonte shumë.SA enderrime kam ndare me ty.Me duket se të gjitha ato ç'të pata thënë e besuar se do të ndodhnin,me vdiqen ne ato çaste.

T'i thashë të gjitha.TE gjitha me ndodhen mua.Dy dashuri te humbura nuk janë pak.Njëra për një burrë te martuar,ndërsa tjetra për "gruan e tij".Tani qe t'i thashë ty te gjitha,se pares dhe te vetmes,jam me mirë.Tani them te cohem nga kompjuteri dhe te shkoj te ha një supe te bukur.

31 dhjetor 2003